

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVII i botimit, nr. 198, Prill 2020

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355674001940, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Suela Ndoja, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

10 MILIONË LEKE PËR TË VARFRIT, PA DALLIM KRAHINE DHE BESIMI

2

ATDHETARI Z. NDUE FTONI NDIHMON 100 FAMILJE NË VARFËRI EKSTREME

Nuk e kisha imagjinuar se një telefonatë e papritur nga USA e z. Ndue Ftoni do të më kishte shkaktuar njëherësh edhe gëzimin, edhe përgjegjësinë për një angazhim serioz në bërjen realitet të një bamirësie të konsiderueshme, dhurimin e 10 milion lekëve të vjetra 100 familjeve në Bashkinë Shkodër. Do të ishte vërtetë një ndihmë e mirë për familjet më në nevojë në këto ditë të pritjes së Festës së Pashkës. Nga ana tjetër kjo do kërkonte një zgjidhje të shpejtë dhe të sigurtë, pasi transparenca në raste të tilla është themelore.



ARTIKULL NGA NATIONAL GEOGRAPHIC - KUSH JANË SHQIPTARËT?

3

Shqiptari është europian: për më shumë se dymijë vjet ka jetuar atje ku jeton tani—në fortesat e Epirit dhe Ilirisë, përtej Adriatikut paralel me thembrën e Italisë. Në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë, shqiptarët u përzienë me fqinjët e tyre jugorë, grekët dhe ishin shtylla kurrizore e luftës për pavarësinë e Greqisë. Bashkatdhetarët e Marko Boçarit emigruan të gjithë në Cefaloni, në brigjet e Greqisë, por afro 2 milionë shqiptarë më të pafatë jetojnë tashmë nën sundimin turk.

Sot shqiptarët, arabët, armenët, bullgarët, grekët, serbët dhe vetë turqit po vuajnë, siç ka ndodhur prej dekadash, nga plaga e sundimit turk. Nga këta popuj të pafat, shqiptarët janë të parët që duhet të tërheqin vëmendjen e një bote joegoiste.

PANDEMIA NË STINËN E PRANVERËS

6

- REFLEKTIM PSIKOLOGJIK BAZUAR NË LIBRIN

"NJERIU I FUNDIT" TË NOVELISTES MARY SHELLEY -

nga Suela NDOJA

Edhe kur asgjë nuk po ndodh, diçka po ndodh. Ky është një fakt i vështirë për njeriun për ta kuptuar në mënyrë të vetëdijshme- posaçërisht për ne homo-sapienët modernë, të cilët adhurojnë me kaq zell majën piramidale të produktivitetit dhe kështu gabojmë në mënyrë të para-vetëdijshme zënkën për efektivitet, për shtytje drejt përparimit. Kur i referohemi këtij paragrafi menjëherë na vjen parasysh heshtja ose qetësia. Mirëpo a mund të heshtim kur po shohim se çfarë është duke ndodhur rreth e rrotull nesh? A mund të qëndrojmë dot të qetë për të treguar një formë veprimi të moderuar dhe një element në avancimin, në evolucion, në të gjitha lëvizjet përpara?

Ekzistojnë momente të caktuara, si kur dimri zvarritet në pranverë, kur vetë natyra na kujton këtë fakt elementar të rrëshqitshëm: sythat kanë filluar të dalin duke na treguar se ka lulëzim; dallëndyshet me cicërimat e tyre na tregojnë fillimin e shtegtimt të tyre drejt vendeve të ngrohta, etj.

PËRGJAKJA E KAÇURRELAVE

Këtë tregim ia kushtoj Poetit, Kompozitorit e Këngëtarit Gac Çuni, që vdiq me 24 prill 1956 në burgun famëkeq të Burrelit

Aty ishte edhe Profesori, edhe Mjeku, edhe Filozofi, edhe poeti, edhe këngëtar. Jeta e mbërthyer në darët e betonit e nofullat e ftohta metalike s'kishte se ç'të bënte tjetër përveçse të jetonte vetveten. Dituria vërtet mbartet në kokën e njeriut, por nuk mund të kyçet në kuvli ku dhuna shfrynë pushtetin e saj. Atë natë dhjetori të gjithë shikonin njëri-tjetrin. Diçka mungonte... e patjetër ajo që mungonte ishte liria! Profesori diçka shkruante në një letër cigareje me një lapsë të mprehur hollë. Mjeku shikonte muret e betonta të veshura me mykun kundërmues dhe patjetër lexonte rrezikun e shëndetit të tyre që po shterohej çdo ditë. Filozofi kishte vendosur gishtin në tëmthin e majtë të kokës dhe sic dukej bluante me mendje gjithë kafshatat e hidhura që koha e dhunës ua kishte vënë nën tryezabetonin e burgut të Burrelit, të tjerët shikonin si qenie të vendosura...

5

"TAKOJ EMOCIONET"

Emocionet janë themelore, sepse i japin gjallëri, ditë pas dite, jetës sonë. Ato mund ta kushtëzojnë në mënyrë pozitive apo negative humorin tonë, reagimet tona me të tjerët, me një fjalë mund të kushtëzojnë lirinë dhe lumturinë tonë. Atëherë, çfarë duhet të bëjmë? Para së gjithash t'i njohim dhe pastaj të mësojmë t'i mbarështojmë ato, pasi nëpërmjet një njohje të saktë të emocioneve dhe të një mbarështimi të vetëdijshëm dhe të pjekur të tyre, mund të jetojmë në harmoni me veten dhe me të tjerët. "Takoje emocionet" është një shprehje e cila do të trajtojë pikërisht këto njohje dhe mbarështim të emocioneve njëri-tjetri me të cilat bëjmë përvojë çdo ditë secili prej nesh.

13

MARASH KOLA ËSHTË NGA ATA PERSONALITETE, QË JETON EDHE PAS VDEKJES

Që nga sot nuk do ta kemi më midis nesh të mirin Marash Kola. U lind më 13 korrik 1931 dhe u nda nga jeta më 31 mars 2020. Ai u lind në Lotaj të Shalës, në një familje me tradita të larta për të cilat punuan në të gjitha kohërat dhe për të cilat punoi edhe vetë Marashi deri sa u nda nga jeta, pavarësisht se ishte në angazhime zyrtare në nivele të larta. Marashi ishte nip në shtëpinë e Baqir Kollës në Shtëpinë e Lul Gjokës në Gjelaj të Thethit.

8



10 MILIONË LEKE PËR TË VARFRIT, PA DALLIM KRAHINE DHE BESIMI

ATDHETARI Z. NDUE FTONI NDIHMON 100 FAMILJE NË VARFËRI EKSTREME

Nuk e kisha imagjinuar se një telefonatë e papritur nga USA e z. Ndue Ftoni do të më kishte shkaktuar njëherësh edhe gëzimin, edhe përgjegjësinë për një angazhim serioz në bërjen realitet të një bamirësie të konsiderueshme, dhurimin e 10 milion lekëve të vjetra 100 familjeve në Bashkinë Shkodër. Do të ishte vërtetë një ndihmë e mirë për familjet më në nevojë në këto ditë të pritjes së Festës së Pashkës. Nga ana tjetër kjo do kërkonte një zgjidhje të shpejtë dhe të sigurtë, pasi transparenca në raste të tilla është themelore.

Duke rikthyer në vëmendjen e të gjithëve, z. Ndue Ftoni jeton prej më shumë se 20 vitesh në Detroit, Miçigan, USA së bashku me familjen e tij. Ai është lindur në Shosh, por në moshë fare të re u zhvendos prej aty në kërkim të një punësimi, pavarësisht se rrugët e shkollimit të mëtejshëm iu ndërpre për shkak të biografisë së familjes së tij, e cila u pa shtrëmbër nga regjimi gjatë monizmit. Para se të largohej në Amerikë, jetonte në Gur të Zi. Edhe pse që aty i dha shenjat e një sipërmarrësi të vogël, realiteti shqiptar nuk ofronte mundësi për të ecur përpara, por vetëm të krijonte hapësirë për mbijetesë. Pas shumë peripecish që lidhen me largimin dhe më pas stabilizimin e tij në USA, falë natyrës së tij guximtare, arriti të ecte përpara duke ngritur një biznes të tij. Pavarësisht fitimeve që rrodhën, atë nuk e tjetërsoi paraja. Përgjatë 20 viteve paqesur ndërmoi një seri veprimtarish bamirësie në ndihmë të familjeve në nevojë, apo dhe mundësi të veprimtarie kulturore. Pak kohë më parë kontribuoi me 5000 \$ në ndihmë të një familjeje në Fushë-Arrëz, së cilës iu dogj shtëpia dhe mbetën 4 jetimë nga kjo fatkeqësi. Së fundmi ka qenë iniciator i asfaltimit të rrugës së Dukagjinit, me idenë e mirë të bashkojë jo thjeshtë dukagjinasi, por gjithë banorët e Shkodrës në presionin që duhej të ushtronin ndaj qeverisë shqiptare në realizimin e kësaj rruge, e cila deri më tani u ka marrë jetën 53 personave. Të mos harrojmë punën e tij për të mbledhur 11 mijë dollarë, kontribut i tij dhe i bashkësisë shqiptarë në USA në vitin 2007, viti i zymtë, kur humbën jetën 10 persona gjatë një aksidenti në Karmë të Kirit.

Por le t'i rikthehem realitetit të sotëm dhe angazhimit në një proces të radhës, që do të evidentonte edhe një herë natyrën humaniste të atdhetarit Ndue Ftoni, i cili zgjodhi t'i gjendej banorëve të Bashkisë Shkodër afër, jo thjeshtë në këto ditë të festimit të Pashkës, por më shumë në këto ditë të vështira të pandemisë së Covid-19.

Duke u bazuar në besueshmërinë që rrjedh nga puna, të cilën po e bën së fundmi Bashkia Shkodër në ndihmë të mbi 1300 familjeve në nevojë, e ku do kishte zgjidhje më ideale sesa t'i drejtoheshim

vetë titulluarës më të lartë zj. Voltana Ademi, e cila pasi përgëzoi biznesmenin Ndue Ftoni për humanizmin e tij të vjueshëm në Shkodër, pranoi me vullnet dhe dëshirë që të bëhej koordinatore në



Ndue Ftoni

gjetjen e 100 familjeve duke përpiluar listat e banorëve më nevojtarë në këtë bashki.

Voltana: Jemi në një operacion që ka nisur prej 5 javësh, Çdo ndihmë e vullnetarizmit është për tu lavdëruar edhe kur vjen përmes orientimit të gazetarëve. Unë u njoha paraprakisht me dëshirën e z. Ndue Ftoni për të ndihmuar familjet. Patëm mundësinë të bisedonim edhe bashkë për humanizmin që ai dëshironte të bënte në Bashkinë Shkodër. Ne zgjodhëm familjet më ekstreme në nevojë, të



Përfaqësuesi i Bashkisë Shkodër, Ndoc Ashta, duke shpërndarë ndihmën.



cilat jo thjeshtë do gëzoheshin për festën e Pashkës, por shuma e dhuruar është edhe një ndihmë e rëndësishme ekonomike për ta. Ky nuk është humanizmi i parë i z. Ftoni, por në rastin e pandemisë konsiderohet veprim i parë i tij. Ne përcaktuam familjet në varfëri ekstreme, me, aftësi ndryshe, të moshuar, pa pensio-

ne, të sëmurë që jetojnë vetëm apo kanë fëmijë që nuk arrijnë dot t'iu japin ndihmë. Kemi pasur edhe 2 raste të tjera që na kanë ndihmuar nga jashtë Shqipërisë, të cilët kanë pasur lidhje shpirtërore me Shkodrën. Edhe z. Ftoni ka po ashtu këtë lidhje. Dua ta përgëzoj atë dhe shpresoj që familja e tij të jetë mirë, po ashtu bashkësia shqiptare në Miçigan të jetë mirë. Ky është një kontribut që i japim familjeve që kanë nevojë. Ne do ta kalojmë këtë situatë falë solidaritetit të miqve tanë në ditë të vështira.

Grupi i punës që u ngrit, me përfaqësues të z. Ndue Ftoni (Sokol Gjoni dhe Ramzan Çeka), por dhe të Bashkisë Shkodër (Ndoc Ashta), duke iu referuar listave të familjeve më në nevojë të evidentuara nga vetë ajo, nisën shpërndarjen e 10 milion lekëve të vjetra, fillimisht në zonat rreth qytetit të Shkodrës. Çdo dhurim u pasqyrua për transparençë në listat përkatëse, ku çdo përfitues shënonte numrin identifikues në kartën e identitetit dhe firmoste.

I pyetur nga mediat shqiptare dhe ato në USA (ACTV), lidhur me arsyet se përse duhej ta bënte një humanizëm të tillë, mes të tjerave z. Ftoni u shpreh se ndiente keqardhje për situatën ekonomike të qeverisjes disa vjeçare në Shqipëri. Është e pafalshme që gjendja mbetet e njëjtë edhe pse qeveritë i kanë lënë radhën njëra-tjetër për të menaxhuar pushtetin.

Për fat të mirë, familja asnjëherë nuk



Pamje nga dhënia e ndihmës



e ka kundërshtuar në veprimtaritë e tij me karakter bamirësie dhe humanizmi. "Jemi menduar shpesh që edhe 1 dollar i familjes sonë, po të jetë nevoja t'ua çojmë familjeve në nevojë" - ka thënë z. Ftoni..

Theksojmë raportet e ngushta shpirtërore që z. Ndue Ftoni ka me Shkodrën. Këtë e ka treguar më së miri duke

bërë mundësi të shumta. Për momentin ai nuk është aktiv në fushën e biznesit në USA, pasi i ka shitur subjektet e tij private. Edhe në këto rrethana z. Ftoni nuk është ndalur për të bërë akte bamirësie. Akte të tilla janë pak ose aspak të dëgjura në bashkësinë shqiptare në Amerikë. Shoqata "Malësia e Madhe", në USA ka bërë disa organizime, sidomos për kontribute në Tuz. Por në drejtim të Shqipërisë janë akte të padëgjura. Me sa duket kësaj radhe është vënë në test pasuria e zemrës dhe llogaria bankare.

-Nuk jep ai që ka, por jep ai që ka zemër,- thotë Ndoja. Unë e ndiej veten të detyruar dhe duhet të ndihemi kështu ndaj njerëzve në nevojë. Unë nuk kam dhënë se më kanë tepruar paratë, por përderisa fëmijëve të mi nuk u mungon asgjë, atëherë përse të mos mendojmë edhe për të varfrit. Përgjatë 20 viteve mu dha mundësia të ec përpara në jetë duke bashkuar sinqeritetin, kurajën guximin në këtë vend. USA i jep mundësinë gjithkujt për të punuar në rrugë të drejta. Bizneset e tash 20 vite kanë pasur rezultat. Si i pasuri dhe si i varfëri duhet ta kuptojnë se në botën tjetër nuk do marrin asgjë me vete. Unë nuk mendoj të zgjidh hallin e gjithë banorëve të Shkodrës, por mendova që 100 familje të kalojnë mirë Pashkën. Le të kalojë sa më shpejtë kjo krizë. Shteti duhet të jetë përgjegjës për popullin që i ka dhënë votën. Qeveria, edhe pse po bën ndaj këtij populli, duke u përpjekur për ta ruajtur jetën e këtyre njerëzve, duhet të bëjë më shumë në aspektin ekonomik, për të mbështetur familjet në nevojë.

Grupi i punës përgjatë 2 ditëve, punë të lodhshme, ka kontaktuar me 100 familje. Një pjesë e kontakteve janë bërë nga takimet e drejtpërdrejta me personat nevojtarë. Në rastet e pamundësisë së tyre për të lëvizur, ka qenë një përfaqësues i familjes që ka tërhequr shumën e dhuruar.

Duke qenë se familjet e varfëra janë të shumta dhe nevoja e tyre është tepër e madhe, rrezja e shpërndarjes u përhap edhe në qytetin e Shkodrës, por edhe në dy familje të Malësisë së Madhe. Trishtim, teksa sheh gjendjen e mjerueshme edhe gëzim njëherësh, që të jepet mundësia t'i lumturosh sadopak, një lloj lumturie që nuk rrjedh nga shuma e dhënë sesa nga fakti që dikush u kujtua për ta në ditë të tilla.

Kudo mirënjohja e këtyre banorëve ka qenë e madhe dhe nuk kanë reshtur së falënderuar atdhetarin Ndue Ftoni, edhe pse një pjesë e tyre thjesht kanë dëgjuar për të, por nuk e kanë takuar nga afër asnjëherë. Ka qenë vetë porosia e tij, që shpërndarja e 10 milion lekëve (të vjetra) të bëhej tek ato familje që vuanin më shumë, pa bërë dallime krahinore apo fetare. Dhe grupi i punës u kujdes që vullneti i mirë, i shprehur që nga kontinenti i largët, të realizohej ashtu

ARTIKULL NGA NATIONAL GEOGRAPHIC - KUSH JANË SHQIPTARËT?

Shqiptari është europian: për më shumë se dymijë vjet ka jetuar atje ku jeton tani—në fortesat e Epirit dhe Ilirisë, përtej Adriatikut paralel me thembrën e Italisë. Në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë, shqiptarët u përzienë me fqinjët e tyre jugorë, grekët dhe ishin shtylla kurrizore e luftës për pavarësinë e Greqisë. Bashkardhetarët e Marko Boçarit emigruan të gjithë në Cefaloni, në brigjet e Greqisë, por afro 2 milionë shqiptarë më të pafatë jetojnë tashmë nën sundimin turk.

Sot shqiptarët, arabët, armenët, bullgarët, grekët, serbët dhe vetë turqit po vuajnë, siç ka ndodhur prej dekadash, nga plaga e sundimit turk. Nga këta popuj të pafat, shqiptarët janë të parët që duhet të tërheqin vëmendjen e një bote joegoiste.

“As rrahjet me thupra, as arma, as topi, as mërgimi, as burgimi, as edhe vetë vdekja nuk i tund nga vendi”.

Folësi ishte një shqiptar i ri në moshë që një pjesë të shkollës e kishte bërë në SHBA. Ai është rikthyer tani në vendin e tij, ku po punon me zell të madh për popullin e tij. Është një prej të paktëve njerëz të arsimuar në Shqipëri, por synon që brezi i ardhshëm të mos i numërojë me gishta burrat dhe gratë e arsimuara të Shqipërisë.

Fjalët e përmendura më sipër u parafrinë prej këtyre: “Për momentin, nga veriu në jug dhe nga lindja në perëndim të Shqipërisë, të gjithë klasat e njerëzve—muslimanë dhe të krishterë qofshin—kanë një dëshirë, pothuajse një pasion për arsimin kombëtar. Të gjithë ata e kuptojnë që, ashtu sikurse në të kaluarën shpata ishte simbol i fuqisë, sot arsimit është perëndesha e fuqisë, dhe ata do të arsimohen, pavarësisht persekutimit”.

Shqiptarët janë vetëdijësuar për nevojën që kanë për qytetërimin dhe progresin perëndimor. Por, që nga dita e parë e miratimit të Kushtetutës së re otomane, turqit e rinj ishin të vendosur që qytetërimi duhej të vinte tek shqiptarët, vetëm pasi të kishte kaluar në një sitë turke dhe mohamedane. Ky program nuk mund të pranohej nga shqiptarët, edhe sikur turqit e rinj të kishin qenë në gjendje ta vinin në zbatim.

Shqiptari është europian. Për më shumë se dymijë vjet ka jetuar atje ku jeton tani — në fortesat e Epirit dhe Ilirisë, përtej

Adriatikut paralel me thembrën e Italisë. Në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë, shqiptarët u përzienë me fqinjët e tyre jugorë, grekët dhe ishin shtylla kurrizore e luftës për pavarësinë e Greqisë. Bashkardhetarët e Marko Boçarit emigruan të gjithë në Cefaloni, në brigjet e Greqisë, por afro 2 milionë shqiptarë më të pafatë jetojnë tashmë nën sundimin turk.

Gjatë 125 viteve para zbulimit të Amerikës, republika krenare e Venecias kishte një supremaci dashamirëse mbi qytetet shqiptarë të bregdetit, dhe kështu që e vonoi me një shekull dominimin turk. Me rënien e Skutarit (Shkodrës) në Shqipëri dhe dëbimin e venecianëve nga turqit në vitin 1748, këta të fundit filluan sundimin e tyre—shekuj të tërë mashtrimi, bese të thyer dhe mizorie. Rezultati i sundimit turk mund të përmbledhet me zhytjen më thellë të shqiptarëve në varfëri, supersticion, dhe etje për gjak, për shkak të terrenit pjellor që garantonin historia malore dhe tiparet primitive. Përgjatë dy mijëvjeçarëve, valët dhe impulset e progresit nuk e kanë arritur shqiptarin, ose e kanë anashkaluar, duke e lënë të paprekur.

Albanian vilayet (Vilajeti Shqiptar)

Hakmarrja praktikohet ende

Sot, ashtu si në të kaluarën, është e vërtetë që një në pesë malësorë flijohen prej hakmarrjes së tmerrshme, që vetëm qytetërimi mund ta çrrënjosë nga jeta e shqiptarit. Të qëllosh një person, edhe tinëz, është çështje e marrjes së gjakut. Asgjë tjetër nuk mund ta kthejë nderin e plagosur. Nëse nuk vritet vetë vrasësi, atëherë një prej të afërmve duhet të jetë viktimë, e kështu nis zinxhiri i pafund. Kur hakmarrja ka shkuar shumë larg, mund të blihet nëse ke para të mjaftueshme, ose mund të ndalet përmes disa prej kompleksiteteve të kodit të shqiptarit.

Askush nuk duhet të flasë për shqiptarin si njeri pa ligje. Ai zbaton në mënyrë skrupuloze atë që njeh dhe pranon: por, këta janë ligjet që i kanë dhënë natyra dhe zakonet, si dhe natyra e paraardhësve të tij shekuj më parë, të “kodifikuar” disi në shekullin 15, ndonëse edhe sot e kësaj dite nuk janë hedhur asnjëherë në letër. Disa prej rregullave të çuditshëm që udhëheqin jetën e tij janë: Persona që e kanë prejardhjen nga një stërgjyshi i përbashkët mashkull, përmes linjës mashkullore, e

konsiderojnë njëri-tjetrin vëllezër, ose vëlla e motër, e si pasoja martesë brenda fisit përjashtohet. Të rinjtë mund të betohen për vëllazëri, dhe kjo krijon një marrëdhënie që i nënshton të dy, bashkë me pasardhësit e tyre të disa brezave, para të njëjtëve ligjeve martesore që rregullojnë edhe lidhjet e gjakut.

Personat që kanë të njëjtin kumbar nuk mund të martohen, dhe ka dy lloj kumbarësh: ai i pagëzimit dhe ai i flokut. Kur një fëmijë, vajzë apo djalë, mbush 2 vjeç, flokët e tij që deri atë çast nuk janë prekur prej gërshtëreve, priten me ceremoni. Prej rjen e kryen kumbari, që më pas, nëse fëmija është i krishterë lë nga një tufë flokësh për secilën majë të busullës duke krijuar një kryq. Nëse është mysliman, tri tufa për të formuar një trekëndësh. Në rastin e hakmarrjes, burri nuk duhet prekur nëse shoqërohet nga një fëmijë apo një grua.

Luftëtari i Maleve (Pikturë nga Lek Pervizi)

Personalitet i pathyeshëm

Sot, shqiptari është personaliteti më piktoresk në Europë.

Megjithatë, po aq interesante sa tiparet e tij, është edhe e ardhmja e tij politike. Kohët e fundit është shfaqur vetëdija kombëtare shqiptare që refuzon të shtypet. Nën qeverisjen jonormale të turqve, racat e ndryshme të krishtera të Perandorisë, si armenët otomanë, bullgarët otomanë dhe grekët otomanë, kanë secila ekzistencën e tyre kombëtare, një shtet brenda shtetit, ndonëse gjithmonë të nënshtuar vullnetit të turqve. Shqiptarët, ndonëse në përgjithësi kanë zhvilluar një lloj besnikërie myslimane që u jep një pothuajse solidaritet me turqit, janë të vendosur që të kenë edhe ata një entitet kombëtar.

Ndonëse janë të mallkuar me prapambetjen që ka shoqëruar pak a shumë kudo besimin mohamedian, liderët e tyre e kuptojnë se nuk janë një racë orientale, por perëndimore. Se tiparet e tyre turkomohamedane janë një lustër, dhe se do të mjaftojë një brez me arsimin e duhur për të bërë kërcimin e madh përpara dhe për të zënë vendin e tyre mes racave të qytetëruara të gadishullit të Ballkanit.

Jo i papajtueshëm me nacionalizmin e ri shqiptar — madje mund të jetë arsyeja e tij — është fakti që shqiptari është një prej anëtarëve më individualistë të racës

njerëzore. Po të mos kish qenë i tillë, ai do e kishte humbur shumë kohë më parë identitetin e tij, duke u shkrirë me popujt e ndryshëm që përgjat kohërave u kanë ardhur rrotull maleve shqiptare. Pavarësisht sulmeve të vazhdueshëm të romakëve, gotëve, serbëve dhe bullgarëve dhe 350 viteve dominim të Turqisë, shqiptari e ka ruajtur individualitetin e tij të pathyeshëm. Crispi, burri i shtetit italian ka qenë me prejardhje shqiptare. Ai ishte pjesëtar i kolonisë së madhe të shqiptarëve në Sicili dhe Italinë e Jugut, paraardhësit e të cilit, afro njëqindmijë, emigruan kur Turqia pushtoi Shqipërinë. Edhe sot e kësaj dite, Shqiptarët e Italisë e ruajnë prejardhjen e tyre. Mosgatishmëria ose paafërsia e shqiptarëve për të ndryshuar individualitetin e tyre reflektohet tragjikisht në ekzistencën e vazhdueshme të sistemit fisnor shqiptar dhe grindjet e përhershme mes fiseve. Si rezultat, Shqipëria nuk ka mundur të paraqesë një front të bashkuar kundër një armiku të përbashkët.

Vetëm një hero i madh bashkues kombëtar ka dalë për shqiptarët — Skënderbeu. Ai vdiq në vitin 1467, pasi fitoi 21 beteja kundër turqve. Vdekja e tij e la Shqipërinë pa udhëheqës, dhe shqiptarët trima që nuk njihnin besnikëri apo ligj tjetër përtej atij të familjes dhe klanit, ranë në sundimin e Mehmetit II, pushtues i Kostandinopojës. Sulltan Mehmeti mundi t’i shtypte, por jo t’i nënshtonte shqiptarët. As edhe sulltanët e mëvonshëm nuk kanë arritur ta plotësojnë këtë dëshirë të madhe. Më e mira që mund të bënin ishte t’i bënin për vete, dhe deri në ditën e fundit të tiranisë së Abdyl Hamitit, shqiptarët trajtoheshin si popull i veçantë. Hamiti ua bleu besnikërinë duke mos u vënë taksa, duke frenuar rekrutimin ushtarak dhe duke përzgjedhur më të mirët e këtyre malësorëve të ashpër si truporjat e tij personale.

Mehmet Shukru Pasha — (Lufta Ballkanike)

Turqit e rinj ishin të pamëshirshëm

Kur pas vitit 1908, turqit e rinj kishin miratuar Kushtetutën e tyre dhe po përpqeshin me shumë mundime të vinin rregull në Perandorinë otomane, trajtimi i Shqipërisë ishte një prej problemeve më delikatë. Duhej të ishte bërë më me kujdes. Përmes një trajtimi delikat, përbushjes së premtimeve dhe shfaqjes se një simpatie të dre-

siç duhej në atdhe.

Në fjalën e saj kryetarja e Bashkisë Shkodër, **zj. Voltana Ademi**, u shpreh se deri tani ka pasur edhe 2 iniciativa të tjera të emigrantëve që kanë menduar dhe kontribuar për vendin e tyre në këtë situatë të pandemisë, e cila përfshiu dhe vendin tonë. Kjo është një shifër tepër e ulët duke menduar numrin e madh të biznesmenëve, si brenda ashtu dhe jashtë vendit, që e kanë Shkodrën vendlindjen e tyre. I gjendur përpara kësaj shifre, biznesmeni Ndue Ftoni ka dhënë këtë mesazh për gjithë biznesme-

nët.

Mesazh biznesmenëve: “Jo se i kemi kujt borxh, por duhet t’i kemi borxh Zotit. Ne dalim në foto në rrjetet sociale dhe ekspozojmë udhëtimet tona me pushime, duke u shitur mend edhe hallexhinjve në Shqipëri. Unë u bëj thirrje gjithë shqiptarëve që, duke mos e ndërë shumë ngarkesën, secili ta ndajë qoftë dhe 1 dollar me këta njerëz që nuk kanë bukën sot. Duhet ndihmuar këta njerëz, që së paku të kenë të siguruar bukën e gojës. Secili biznesmen ta rezervojë 100 apo 1000 dollarë për njerëzit që kemi atje në Shqipëri.

Të mos harrojmë se si jemi rritur në kohën e diktaturës. Nëse jemi majë luksit duhet të kemi në mendje shpirtin e atij atje në vuajtje. Shkodra rezultoi bashkia më pak e ndihmuar nga qeveria shqiptare. Ajo është kryeqendra e veriut dhe gjithmonë ka votuar për PD. Fatkeqësia është se të dyja partitë kryesore asnjëherë nuk janë bashkuar në një pikë. Qeveria duhet t’i ketë të gjithë njerëzit njëllor dhe nuk duhet të bëjë dallime mbi bazën e bindjeve partiake. Ndihma nuk jepet në bazë të bindjeve politike. Padrejtësitë që po i bëhen popullit shqiptar, Zoti ua ktheftë në

kokat e tyre. Virusi që ia hoqi buzëqeshjen botës nuk do ta ketë jetën e gjatë. Uroj të kemi sa më shpejt një zgjidhje për ta kaluar këtë situatë. I uroj besimtarët të fitojnë forcë në vete dhe të kërkojnë ndihmë nga Zoti për ta përballuar. Virusi ua ka tharë zemrat gjithë njerëzve të botës, por ne mund t’ia dalim. Për këtë duhet solidaritetin e të gjithëve”. -ka shprehur optimizmin e tij atdhetari Ndue Ftoni.

Përgatiti, **Kozeta Bruçi**, gazetare Shkodër, më 14. 04. 2020

jtë për aspiratat e një race injorante por shumë të zotë, turqit e rinj do të kishin qenë në gjendje të ngrinin dhe forconin në provincën e Shqipërisë një barrierë të padepërtueshme ndaj agresionit evropian. Në vend të kësaj, ata kanë ndjekur një rrugë që është përshkruar siç duhet nga korrespondenti në Kostandinopojë i "Times"-it të Londrës, si politika e rullit me avull. Duke injoruar këshillat e çdo politikani me përvojë, turqit e rinj nxituan t'i "trajtonin" shqiptarët njësoj si fshatarët injorantë turq në Azinë e Vogël.

Asnjë strategji tjetër nuk do të kish qenë më e pavyend dhe më e destinuar të dështonte.

Albania - A group of rebel Albanian chiefs uprising against Turkish rules. - Image by © Theron J. Damon/National Geographic Society/Corbis

Shenjat e para të një kundërshtimi u dhanë që në vjeshtën e vitit 1909, por duhej të vinte pranvera e vitit 1910, që një revoltë të merrte përmasa serioze. Në 5 prill të atij viti, shqiptarët myslimanë të skajit verilindor të Shqipërisë rrëmbyen armët kundër qeverisë. Për pak ditë rebelët mbajtën Kaçanikun, por 50 mijë trupa turke u dërguan menjëherë në rajon dhe lëvizja u shtyp. Ajo pati një karakter lokal dhe nuk kishte organizim. Shqipëria si e tërë nuk ishte qëllimi i saj.

Megjithatë, turqit e rinj menduan se kishte ardhur koha t'u jepnin një mësim shqiptarëve të pabindur. Trupat që ishin mbledhur për të shtypur kryengritjen marshuan nëpër Shqipëri. Një divizion shkoi në perëndim, në Shkodër. Ata përshkuan rrugë malore që për breza të tërë ishin mbyllur për këdo që udhëtonte i shoqëruar nga një ushtar turk, sepse shqiptarëve nuk u pëlqente uniforma e autoritetit turk. Por tani malësorët, të zënë në befasi, do të çarmatoseshin. Pas shtypjes që kishin pësuar sivëllezërit e tyre, më të paktë në numër dhe të gjendur përballë automatikëve – një tmerr i pazakontë për shqiptarët e thjeshtë – nuk kishte shpresë për rezistencë. Armët e tyre – krenaria dhe zotërimet – iu morën, dhe shqiptarëve iu "dha një mësim" mizor. Një tjetër divizion i forcave turke marshoi në jug dhe penetroi në luginat paqësore të Shqipërisë.

Në Elbasan, udhëheqësit intelektualë të Shqipërisë së Re kishin hapur një shkollë normale. Ata po përpqeshin të përgatisnin shqiptarët që të bëheshin mësues të bashkatdhetarëve të tyre injorantë në të gjithë vendin. Përdornin gjuhën shqipe dhe, sipas votimit të një kongresi shqiptar të një viti më herët, e shkruanin këtë gjuhë – një gjuhë europiane – me shkronja latine. Nën Abdyl Hamitin, çdo përpjekje për të shkruajtur apo dhënë mësim në gjuhën shqipe ishte shtypur. Vetëm në shkollat e misioneve austriake dhe italiane në veri të Shqipërisë, ku ofrohej propaganda austriake dhe italiane, dhe jashtë survejimit të Sulltanit, kishte qenë e mundur që shqiptarët të studionin në gjuhën e tyre.

Sa për një alfabet, politikanët austriakë që mbështesin punën misionare të priftërinjve austriakë dhe nuk pushojnë asnjëherë së çuari përpara skemat austriake, shihnin me dyshim nga një e ardhme për Shqipërinë, liderët e të cilës të mësuar në Itali apo Austri do të bashkoheshin nga një gjuhë dhe alfabet i përbashkët. Kështu

u krijua një alfabet i gjatë dhe iu ofrua fëmijëve në shkollat e misioneve austriakë. Kjo do të ndihmonte për të krijuar të çara për të ardhmen, kur Austria shpresonte që do të trashëgonte këtë tokë dhe do të kishte të nevojshme të përdorte tiraninë e saj dinake për të austrianizuar shqiptarin.

Shkolla normale e Elbasanit, me alfabetin e saj latin dhe e çliruar prej propagandës së huaj ishte një rreze drite në errësirën e Shqipërisë. Ajo nuk kishte ndarje fetare – myslimanët dhe të krishterët ishin vëllezër pa dallim. Themeluesit kishin vetëm një qëllim, lartësimin e racës shqiptare. Ata nuk ishin revolucionarë në kuptimin politik të fjalës. Ata donin të bashkëpunonin me qeverinë e turqve të rinj, dhe vetëm kërkonin që zbatimi i kushtetutës së re të kishte diçka të përbashkët me premtimet e saj themelore.

Por kur ushtarët turq erdhën në Elbasan në verën e vitit 1910, u shpall gjendja e jashtëzakonshme. Të gjithë ata që shiheshin se kishin lidhje me shkollën normale apo simpatizonin përparimin e saj u ndoqën, u sollën para autoriteteve ushtarake dhe u rrahën në një mënyrë shumë mizore për t'u rrefyer. Rrahja me thupra dhe kamzhik u zbatuan për shumicën e njerëzve të iluminuar në Elbasan. Financieri i shkollës normale u fshikullua përtej çdo imagjinate. Drejtori dhe shumë prej mësuesve u arratisën. Autoritetet ushtarake kërkuan dhe rrahën personat përgjegjës për një telegram që ishte dërguar në drejtim të Kostandinopojës, ku kërkohej që mësimi në shkollat shqiptare duhej bërë në gjuhën shqipe dhe me gërma latine. Më tej ushtarët marshuan për të bërë punë të tjera "pasi kishin mbyllur atë shkollë dhe u kishin dhënë shqiptarëve një mësim për t'u mbajtur mend".

Krenët e Malsis 1908 (marubi)

Kryengritjet e shqiptarëve

Me kalimin e 1910, telashet nisën të shtohen për turqit në kancelaritë e Europës, sidomos për skandalin e orgjive të ushtrisë në Shqipëri dhe mbylljen e shkollës normale, ashtu sikurse dhe për çarmatimin brutal të të krishterëve në Maqedoni. Në Europë ekzistojnë gjithmonë disa palë, interesat politikë të të cilave mund të çohen përpara duke përkrahur të shtypurit. Dhe ndonëse ishin motive hipokrite ata që vunë në lëvizje shumë burra shteti evropianë që ndihmuan për shfaqjen hapur të këtyre ngjarjeve, e vërteta e bëmave të turqve të rinj në Shqipëri dhe Maqedoni gradualisht u bë e njohur për të gjithë.

Turku i ri ishte shfaqur tamam si biri i babait. Udhëheqësit panë që kishin bërë një gabim, por ata nuk do ta pranonin dhe ngjarjet e mëvonshme kanë treguar se nuk ndërruan mendje. Në prill 1911 ndodhi një kryengritje e malësorëve në provincën e Shkodrës, në veriperëndim të Shqipërisë përgjatë kufirit me Malin e Zi. Revolta ishte një prej përpjekjeve të parakohshme dhe të pafata të një populli të dëshpëruar dhe trim, por të përçarë, për t'u hedhur kundër zgjedhës së paterueshme. Në vend të shndërrohej në një revoltë të përgjithshme, kryengritja mbeti e kufizuar në skajin më verior të Shq-



ipërisë.

Patriotët e vërtetë të të gjithë Shqipërisë i hedhin tutje dallimet fetare dhe fisnore kur gjenden përballë fakteve të mëdhenj të një trashëgimie të përbashkët dhe kundër një zgjedhe të përbashkët. Ata, pjesëtarët e arsimuar të racës së tyre, po luftonin fort vitin që kaloi për një përpjekje të përbashkët në kërkim të drejtësisë për të gjithë Shqipërinë. Fatkeqësisht, këta udhëheqës ishin të keqorganizuar, pa financime dhe pa përvojë. Ata nuk morën mbështetje prej pjesës më të madhe të fiseve myslimanë, shumë prej të cilëve, megjithatë kishin qenë kaq të çarmatosur sa që nuk mund të mendonin të bashkoheshin në një rebelim. Mirditorët katolikë, një fis i fortë në jug të Shkodrës kishin pak pushkë, të gjitha të vjetra dhe hezituan të vijnë në ndihmë të revoltës së malsorëve, deri kur ishte shumë vonë.

Shkodër, Albania — Children in uniforms echo attend an Austrian school in Scutari. — Image by © Theron J. Damon/National Geographic Society/Corbis

Mali i Zi ishte shtylla mbështetëse e kryengritjes, përmes mbështetjes që ai dhe qytetarët e tij i dhanë refugjatëve shqiptarë të cilët dimrin e mëparshëm kishin kaluar kufirin dhe që në pranverë u rikthyen në Shqipëri, gati për luftë. Në këtë mënyrë u "grupos" thika që për breza të tërë ishte hequr nga këllëfi mes sllavëve të Malit të Zi dhe shqiptarëve autoktonë.

Por, Mali i Zi u gjend rrezikshëm i përfshirë në çështjet shqiptare, në mospërputhje me diplomacinë europiane dhe sidomos mikun e vet, Rusinë. Kështu që, në fund Mali i Zi e la Shqipërinë në baltë. Pavarësisht këtij fakti, turqit u detyruan të bënin paqe me malësorët rebelë, duke u bërë atyre kaq shumë lëshime, sa që nisën të shfaqen ankesa nga popullsia myslimane e Shkodrës, që nuk ishte rebeluar.

"Çfarë! Ju u ofroni favore rebelëve?!", thanë ata.

"Po kush ju ka qëndruar besnikë, pavarësisht plagëve të vjetra?!" Ishte njësoj si ankesa e djalit joplangprishës. Fatkeqësisht, turku nuk mundej të zbutte fëmijët e tij besnikë, ashtu siç bëri dikur babai çifut. Sa për marrëveshjen me malësorët, nuk dihej se sa do të zgjaste.

Edith Durham - Mbretnesha e Malsorëve

Shkollat vetëm do i lehtësojnë

E ardhmja e Shqipërisë varet jo vetëm nga vullneti i Austrisë, Italisë, Malit të Zi që mbështetet nga Rusia, i Greqisë dhe i vetë Turqisë, ku secili prej këtyre është i vendosur që të ketë pjesën e vet shqiptare të tortës. E ardhmja e Shqipërisë varet shumë nga sasia e arsimit që mund të vihet në zbatim përpara se të përcak-

tohet përfundimisht fati i 2 milionë banorëve. Me përjashtim të Znj. Edith Durham, gruaja angleze që i ka shkelur vetë zonat më të egra dhe të rrezikshme të Shqipërisë, askush nuk e njeh më mirë këtë vend se sa Z. James D. Bourchier, që për një brez të tërë ka qenë korrespondent special i "London Times" në Ballkan. Artikulli i tij i jashtëzakonshëm për Shqipërinë në edicionin e ri të Encyclopedia Britannica,

pasi flet për betejat e grupeve të izoluar të shqiptarëve konkludon: "Rritja e një ndjenje më të fortë patriotike duhet të varet nga përhapja e arsimit në popull".

Nëse arsimit përhapet pa pengesa në Shqipëri, edhe shqiptarët do të fillojnë të kujdesen për vetveten. Shumë prej shqiptarëve të krishterë në qytetin e Shkodrës janë arsimuar dhe kanë siguruar begati, falë italianëve dhe austriakëve. Ata i druhen sidomos fanatizmit të vëllezërve të tyre myslimanë, ndonëse në malet disa kilometra larg, mes familjeve të malësorëve injorantë, si feja e krishterë ashtu edhe ajo myslimane mund të zënë vend nën të njëjtën çati, dhe ritet e krishtera e myslimane mund të kryhen edhe nën një ndërtesë të vetme...

Disa herë autori i këtij artikulli ka pyetur shqiptarë myslimanë të arsimuar, të interesuar për kauzën e racës së tyre, përse nuk u kanë predikuar myslimanëve të Shkodrës dhe gjetkë vëllazërinë mes të krishterëve dhe myslimanëve. Pa hezitim, por me turp dhe me buzët shtrënguar, përgjigja ka qenë çdo herë e njëjta: "Është e pamundur. Myslimanët janë injorantë. Në fillim duhet të arsimohen, pastaj do ta kuptojnë...".

Pak përpara shpërndarjes së parlamentit, në janar 1912, një deputet shqiptar, njëri prej kryezdhënësve të racës së tij dhe për momentin lider i rebelëve, deklaroi: "Nëse turqit vazhdojnë t'i përbuzin joturqit, ata do e rrënojnë vendin e tyre. E them këtë sepse i dua turqit, ekzistenca e të cilëve është e nevojshme për ne". Deputeti shqiptar fliste për popullin e vet...

Shqiptari ka frikë nga e ardhmja

Shqiptari ka frikë se mos, në vend që të sigurojë lirinë për të cilën është lutur dhe ka luftuar, malet e tij të shtrenjtë dhe luginat pjellore do të ndahen mes shteteve ndërluftuese, dhe se mos ai absorbohet nga një racë e huaj. Austria kërkonon të vijë nga veriu. Italia kanos nga përtej brigjeve të Adriatikut. Këta janë dy armiq që shqiptarët i urrejnë më keq se sa turqit, pavarësisht shkollave, spitaleve dhe kishave që përfaqësuesit e tyre kanë ndërtuar në veriperëndim të Shqipërisë. Shqiptarët i tremben Austrisë dhe Italisë tamam si një polak profetik mund t'i jetë trembur tre grabitësve të tokës mëmë. Shqiptarët i druhen po kështu një Konferencë Europiane për këtë qëllim, se mos Mali i Zi dhe Greqia lejohen që të zgjerohen në kurriz të shqiptarëve. Alternativa ideale që ai do të dëshironte është një Turqi e mirëqeverisur, për të cilën ai do të jetë një prej "ledheve mbrojtëse".

Megjithatë, brezave të tërë sundimi turk u ka mësuar se nuk duhet të presë drejtësi nga turqit. Revolucionin i korri-

PËRGJAKJA E KAÇURRELAVE

Këtë tregim ia kushtoj Poetit, Kompozitorit e Këngëtarit Gac Çuni, që vdiq me 24 prill 1956 në burgun famëkeq të Burrelit

Aty ishte edhe Profesori, edhe Mjeku, edhe Filozofi, edhe poeti, edhe këngëtar. Jeta e mbërthyer në darët e betonit e nofullat e ftohta metalike s'kishte se ç'të bënte tjetër përveçse të jetonte vetveten. Dituria vërtet mbartet në kokën e njeriut, por nuk mund të kyçet në kuvli ku dhuna shfrynë pushtetin e saj. Atë natë dhjetori të gjithë shikonin njëri-tjetrin. Diçka mungonte... e patjetër ajo që mungonte ishte liria! Profesori diçka shkruante në një letër cigareje me një lapsë të mprehur hollë. Mjeku shikonte muret e betonta të veshura me mykun kundërmues dhe patjetër lexonte rrezikun e shëndetit të tyre që po sherohej çdo ditë. Filozofi kishte vendosur gishtin në tëmthin e majtë të kokës dhe siç dukej bluante me mendje gjithë kafshatat e hidhura që koha e dhunës ua kishte vënë përpara në tryezabetonin e burgut të Burrelit, të tjerët shikonin si qenie të vendosura midis dyzatisë vetëdije-mosvetëdije. Në këtë situatë të trishtë ku jeta kishte humbur thuajse gjithë kuptimin, Këngëtarit gjenë kurajën t'ia fillojë një kënge, për të cilën të burgosurit thoshnin se vargjet e saj ishin krijuar në burgun e madh të Shkodrës! Buzët e djaloshit këngëtar filluan të lëviznin lehtë-lehtë, e tingujt e këngës mbushen hapësirën e ngushtë me flutura jonesh muzikore. Intonacioni i zërit sa vinte e shtohet e fytyrat e të pranishmeve sa vinin e zgjoheshin nga ky balsam jetësor, që lubrifikohte sadopak ata shpirtra në kapërcyell të dilemës. Shqisa e të dëgjuarit u ushqye nga vargjet sa melankolike aq edhe muzikore e mjeshtërore: "Naaatyra t'fali bardho o si bora / un përmbas teje, jetën e bora / se të dy sytë m'i kanë verbue / m'i kanë verbue kaçurrelat / kaçurrelat e tue".

Tashmë shigjetat e syve të të gjithëve ishin drejtuar mbi trupin fillak të djaloshit këngëtar. Dikush tha: - Hej mik, mos e ngrit zërin, sepse jemi në burg e këtu nuk lejohet të këndohet! Djaloshi heshti pak sekonda dhe u përgjigj: Jemi në burg, por kënga ka shpirt e nuk mund të vritet, ushqen shpirtrat e duhet të ruhet! Ndërkohë intonacioni i vargjeve të këngës u rrit e ritmi u përshpejtua sikur kaçurrelat e vajzës, së cilës po i këndohej, po shfaqeshin aty përpara të gjithëve. Kur flaka e këtij koncerti, brenda në qeli, po ngrohte qeniet njerëzore të ngujuara, në derën e qelisë u shfaq gardiani. Zemrat u thyen. Pamja e tij i ngjasonte

tigrit të etur që nuk kursen asgjë në botë, pasi bota për të, fund e krye, është vetja e tij, dhe çdo shqyerje e saj përligjet me shërbesën që i bën stomakut. Gardiani me fytyrë të terratisur e duke shtrënguar nofullat artikuloj një pyetje rrëqethëse:

- Kush është ai zog nëne që këndon këtu? Pyetja mbeti pak çaste pa asnjë përgjigje. Sytë e trishtuar u kryqëzuan me shigjeta shikimesh që shprehnin dhimbjen për atë që po gatuhej në ato çaste. Gardiani e përsëriti edhe njëherë pyetjen, e ndërkohë u ngrit në këmbë Filozofi, duke thënë:

- Unë po këndoja një këngë që nana ime ma kishte mësuar që kur isha në prehrin e saj.

- Pa hajde pak në dhomën tonë te ta dëgjojmë këngën e sat ëme, - e urdhëroj gardiani. Kur kishte bërë vetëm hapin e parë



drejt derës, brofi në këmbë Këngëtarit duke folur me një ritëm të përshpejtuar e dialekt verior:

- "Jo shoku gardian, të betohem në shpirtin e nanës teme se këngën nuk e ka kënduar Filozofi, por unë. Asht një kangë që vargjet e saj i thura në burgun e Shkodrës dhe ia kam kushtue një shoqeje që e kam dashur shumë e ndoshta një ditë do të ishte shoqja e jetës teme e pse jo edhe nana e fëmijëve të mi. Ajo më kalonte çdo ditë para dritares së burgut ku rrija unë dhe më përshëndeste me kaçurrelat e saj të zeze... ndaj unë... unë vetëm një kangë, një kangë që ia kisha borxh dhe më duhet me i knue te tan jetën ato vargje i lidha varg në varg me ndjenjat e mija prej një njeriu që kam ndërë shumë për ta".

Gardiani, disi i çuditur për guximin e tij, pasi dihej se ç'priste, iu hakërrua:

- Hajde ti pra se na qenke edhe trim dhe po flitke gjuhen e alpeve! Nofullat e akullta metalike përfaquan kyçet e duarve të këngëtarit dhe bashkë me to kapërcyen

derën hijerëndë të qelisë, e cila u përplas me një krisme të thatë e ngjethëse. Njerëzit e qelisë u ulën ndenjmur në shpinën e dys-hemesë prej betoni, zunë kokën ndër duar dhe filluan të përfytyronin njeriun e tyre këngëtar që tani ndodhej diku tjetër, në një vend pa emër, ku njeriu dergohet pikërisht për ta qëruar nga çdo luspë e të qenit njeri. Jonet e këngës kishin vdekur dhe shpirtrat i ishin drejtuar rrugës së ferrit.

Atë natë nuk pati asnjë sy gjumë për askënd nga banorët e qelisë. Natë dhjetori. Shputat e akullta të erës zbritnin furishëm nga supet e Qafës së Buallit, lëpinin korret e trasha të betonit të burgut e shkundnin me turfullime pjalmicën e borës së thatë që kishte vendosur pushtet në atë pellg vuarjtësh që mund të quhej Kontinenti i Ferrit. Mëngjesi ishte i largët sa vetë rruga e lirisë. Kur viskaja e hollë e të zbardhurit të dritës hyri përmes katrorëve pa xhama të dritares së qelisë dikush foli: O Zot që e fale këtë dritë të hollë, të zbehtë, por gjithësi është dritë, a na tregon nëse këtë dritë mund ta shohë edhe këngëtarit i jonë që na e morën mbrëmë me tinguj kënge në buzë? Sapo mbaruan këto fjalë, u dëgjua një kërcëllime në derën e qelisë. Ajo u hap. Ngritën kokën të shikonin në lartësinë e trupit të njeriut... por asgjë! Dera u mbyllë dhe vetëm atëherë,

nëpërmes asaj drite që kishte filluar të ndriçonte dyshemenë, vunë re se kishte diçka që i ngjante një grumbull leckash. Mjeku u ngrit i pari. Iu afrua. Vuri duart mbi të dhe thirri: Njeri! Është njeri! Oh Zot! Oh Zot! Duart e të gjithëve prekën trupin e ftohtë të tij. E shtrinë. Fytyrën e kishte të mbuluar me gjake. Sytë e mbyllur e të tendosur fort. Nofullat e gungat e ballit të mbuluara me hematoma. Duart ngjyë manushaqe. Gojën e kyçur si morsi.

Ngaqë drita e mëngjesit tashmë i shquante sendet, profili i njeriut u shfaq i plotë e dikush bërtiti: O nëna ime! - po ky është këngëtarit i ynë more! E shikuan dhe u bindën. Mjeku urdhëroi: Hiqini ato rroba e shtrojini në tokë! Ashtu bënë të gjithë njëherësh. E shtrinë mbi to. Mjeku filloj t'i bënte frymëmarrje artificiale. Që në frymëmarrjen e parë një shtëllungë gjakut doli nga goja e tij e përfundoi në gojën dhe buzët e mjekut. Ka vdeke? - pyeti Poeti. -Jo, - tha mjeku nuk e besoj, dhe vazhdoi punën e tij si profesionist i mirë që kishte qënë në jetën e lirë. Kaloi një gjysmë ore, që i ngjante një jete të tërë, sepse jeta nuk matet me kohë, por me çaste. Mjeku futi dorën e tij poshtë rrobës së përgjakur dhe ia vendosi mbi zemër. Të gjithë prisnin dritën e shpresën si njerëzit në momentin e një eklipsi të plotë. Drita për ta ishin vetëm dy fjalë, vetëm dy fjalë: Është gjalle! Mjeku ktheu kokën në drejtim të banoreve të qelisë. Dy pika loti, që i ngjanin rrëshirës, lodronin në sytë e tij: Është gjallë! - tha. Krahët e të gjithëve shtrënguan trupat e ngurtësuar të njëri tjetrit.

Dikush qante, sidomos poeti, i cili në çast krijoi dy vargje të menjëhershme, të cilat i recitoj me ngut: *Ngrij krahët përprjetë, fluturo o pëllumb! / Jeta ime që mbrëmë, nuk e di nga u humb?!*

Mjeku vazhdonte gjithnjë shërbesën mjekësore mbi të. Kaloi një orë, kaloi edhe një tjetër. Shpresa kishte hedhë shtat tek të gjithë. Gëzimi i tyre ishte zhburosor. Pak nga pak Këngëtarit po rilindte. Ngjyrat njerëzore po shtriheshin mbi fytyrën njomëzake, tashmë të fshirë nga gjaku prej shokëve të tij, sytë po ç' tendoseshin dhe goja prej morsi po çelte petalet e buzëve ngjyre mavi. Filozofi u kthye nga banoret e qelisë dhe i pyeti: Më thoni të vërteten, nëse po jetoni tani apo jo? Pooo, - iu përgjigjen të gjithë njëherësh. E shikoni, - tha Filozofi - njeriu e merr jetën me vete ngado që shkon, ajo luan me njeriun, herë ikën herë kthehet, prandaj këtu qëndron bukuria, vlera, përpjekja e domosdoshmëria për ta jetuar. Mjeku komunikoi duke thënë se edhe për pak çaste e Këngëtarit do të përmendej. Tani tryeza e shpirtit të banorëve të qelisë ishte e shtruar me ato jonet muzikore që u ngjanin fluturave, të cilat ishin kthyer nga nata e së mbrëmshmes së bashku me jetën e të burgosurve. Kur gjithë qelia ishte nën sundimin e heshtjes u dëgjuan disa tinguj kënge që u ngjanin belbëzimeve të këndshme të foshnjave. Shikuan njëri-tjetrin. Po, i njihnin tingujt! Përsëri shikuan njëri-tjetrin, me dyshimin se secili në vete po provonte ndonjë reminishencë të natës së mbrëmshme! Por, jo, ishin tingujt që po dilnin nga goja e Këngëtarit. Ishte përmendja e parë, pas natës së tmerrit. Jeta po kthehej me këngë, Dikush tha: Ky është i çmendur, se ta po e marrin përsëri! Tjetri tha: Ky njeri është një Promete! Ndërsa një tjetër tha: Njerëz të tillë lindin për të jetuar të lirë dhe nuk jetojnë pa lirinë. Filozofi përsëriti edhe një herë sentencën e tij: Po, po, kënga ka shpirt e nuk mund të vritet, ushqen shpirtrat e duhet të ruhet! Pas pak Këngëtarit u ngrit në gjunjë e filloj këngën, që ta këndonte të plotë. Të lutem mos këndo - i tha Profesori -sepse për hatrin tonë e ke pësuar edhe mbrëmë. Unë do të këndo deri në vdekje, - tha këngëtarit, edhe për ju edhe për vetën time, jeta ime le të heshtë, por kënga të vazhdoj përjetësisht. Rifilloi këngën me zë të lartë. Frëngjia e vogël komunikuese që ishte në derën e qelisë, u hap. Në ata katrore të vogël u shfaq përsëri fytyra madhoshme e gardianit të egërsuar. Tani me një tonë disi më të qetë, tha: Ti, Gac Çuni je i çmendur, a nuk u mjaftove me natën e mbrëmshme? Mbylli frëngjinë e nuk u pa më. Poeti nxori një letër cingareje dhe filloi të shkruante, pastaj e ngjiti në astarin e brendshëm të rrobave, që të nesërmen t'ia jepte së motrës, ashtu fshehurazi, e një ditë të largët të salvohej në faqet e librit me titull: "Libri i burgut" me poezinë "Elegji për Gac Çunin".

Tregim nga Lazer Kodra

kut 1908, ofroi një rreze të përkohshme shprese, por errësira e dëshpërimit u rikthye menjëherë, më e zezë se më parë... Ndëshkimi me thupra, plumbi dhe qelia e burgut kanë qenë shpërblimi i vetëm pas kërkimit për "diçka më të mirë". Është e vërtetë që, shqiptarët që kishin qenë neglizhuar për shekuj të tërë nuk ishin të gatshëm që të praninin me të mirë disa prej kushteve të "Konstitucionalizmit". Fshatari injorant, që nuk ka paguar asnjëherë taksa dhe nuk është regjistruar asnjëherë për shërbimin ushtarak, nuk e

vlerësonte "barazinë" e re, që iu manifestua atij përmes pagesës së taksave ashtu sikurse të gjithë banorët e tjerë të Turqisë, si dhe për kontributin e kuotave të tij për martirët në tokat e largëta të Jemenit.

Shqiptarët kanë shumë gjëra për të mësuar. Arsimi mund të kishte ardhur tashmë përmes udhëheqësve të tyre të iluminuar.

Shpallja e Pavarsise (foto1913)

Spekulimet për të ardhmen e Shqipërisë të çojnë vetëm në labirinte të papenetrueshëm, pasi problemi i Shqipërisë është i lidhur ngushtë me Çështjen e

Lindjes, ajo që e ka munduar Europën për breza të tërë. Lufta e Krimesë, u zhvillua për ta zgjidhur atë, por në një formë më të komplikuar ajo u rikthye në luftën ruso-turke 1877-1878. Të dërguarit e Europës në Berlin në vitin 1878, e djallosën Traktatin e Berlinit. A mos është shumë të shpresojmë që ka ardhur koha për daljen e një brezi më dashamirës diplomatësh? Megjithatë, Lindja e Afërt shpreson gjithmonë për një zgjidhje dhe për t'u dhënë fund kushteve që, me turqit e vjetër dhe tanimë të rinjtë, po e bëjnë Perandorinë

Otomane thjesht një legjendë...

Sot shqiptarët, arabët, armenët, bullgarët, grekët, serbët dhe vetë turqit po vuajnë, siç ka ndodhur prej dekadash, nga plaga e sundimit turk. Nga këta popuj të pafat, shqiptarët janë të parët që duhet të tërheqin vëmendjen e një bote joegoiste.

National Geographic, Numri i Nëntorit 1912

Paraqiti për botim,
Prof. As. Dr. Zef Gjeta

PANDEMIA NË STINËN E PRANVERËS

- REFLEKTIM PSIKOLOGJIK BAZUAR NË LIBRIN "NJERIU I FUNDIT" TË NOVELISTES MARY SHELLEY -

nga Suela NDOJA

Edhe kur asgjë nuk po ndodh, diçka po ndodh. Ky është një fakt i vështirë për njeriun për ta kuptuar në mënyrë të vetëdijshme- posaçërisht për ne homo-sapienët modernë, të cilët adhurojnë me kaq zell majën piramidale të produktivitetit dhe kështu gabojmë në mënyrë të para-vetëdijshme zënkën për efektivitet, për shtytje drejt përparimit. Kur i referohemi këtij paragrafi menjëherë na vjen parasysh heshtja ose qetësia. Mirëpo a mund të heshtim kur po shohim se çfarë është duke ndodhur rreth e rrotull nesh? A mund të qëndrojmë dot të qetë për të treguar një formë veprimi të moderuar dhe një element në avancimin, në evolucion, në të gjitha lëvizjet përpara?

Ekzistojnë momente të caktuara, si kur dimri zvarritet në pranverë, kur vetë natyra na kujton këtë fakt elementar të rrëshqitshëm: sythat kanë filluar të dalin duke na treguar se ka lulëzim; dallëndyshet me cicërimat e tyre na tregojnë fillimin e shtegimit të tyre drejt vendeve të ngrohta, etj.

Ekzistojnë edhe momente të caktuara në kulturë, kur duhet të kujtojmë veçanërisht, në mënyrë që të qëndrojmë të shëndoshë, këtë fakt elementar të rrëshqitur. Gati dy shekuj para psikologu Daniel Gilbert thoshte se «qeniet njerëzore janë vepra në zhvillim e që gabimisht mendojnë se janë përfunduar» në hetimin e tij të shkëlqyeshëm se si iluzionet tona të tanishme pengojnë lumturinë tonë në të ardhmen, diplomati francez Alexis de Tocqueville, këshillon kundër këtij iluzioni të përfundimtarisë, siç është e vërtetë në shkallën e individëve siç është në shkallën e shoqërive, kombeve dhe civilizimeve:

"Ekzistojnë epoka të caktuara në të cilat ndryshimet që ndodhin në kushtetutën sociale dhe politike të kombeve janë aq të ngadalta dhe të pranueshme sa që [njerëzit] imagjinojnë se kanë arritur në një gjendje përfundimtare; dhe mendja njerëzore, duke besuar se bazohet në mënyrë të vendosur mbi themelet e sigurta, nuk i shtrin studimet e saj përtej një horizonti të caktuar"

Duke sjellë këtë perifrazim, thjesht mund të them se edhe unë sikur shumë e shumë të tjerë, jemi ndodhur në zhytjen e disa proceseve mendore si : duke reflektuar, duke

lexuar, duke reaguar pasivisht apo aktivisht gjithnjë e më shumë si duke pritur të gjendet me padurim ndonjë përgjigje në mos e gatshme, e përafërt për këtë situatë pandemike botërore. A ka ndikuar tashmë në konceptin tonë për jetën në përgjithësi dhe për gjëra specifike në veçanti?

Në këtë kohë, si pjesë e reflektimeve të mia psikologjike, ndër librat e lexuar ka qënë edhe romani "Njeriu i Fundit" i novelistes Mary Shelley. Gjysmë shekulli para se Walt Whitman të konsideronte atë që e bën jetën të vlejshme për të jetuar kur një goditje paralitike e goditi atë për vdekje, Mary Shelley (30 gusht 1797 - 1 shkurt 1851) e vendosi këtë pyetje në rrahjen e zemrës të Njeriut të Fundit - romani i vitit 1826 që ajo shkroi në periudhën më të përgjakshme të jetës së saj: pas vdekjes së tre fëmijëve të saj, dy nga sëmundjet infektive të përhapura që shkenca ka përmbajtur që nga

ajo kohë; pasi i dashuri i jetës së saj, Percy Bysshe Shelley, u mbyt në një aksident me varkë. Nga ajo gropë e mbuluar me trishitim, në faqet e një romani për një pandemi që fillon të fshijë speciet njerëzore një e nga një derisa mbetet një i mbijetuar - protagonist i vetëm autobiografik i Shelley -, ajo ngriti pyetjen jetësore: Pse të jetosh? Ja si e shpreh :

"Ndërsa kjo epërsi pasioni kaloi nga unë, u ndjeva më e përbërë. Unë shtrihem në tokë, dhe duke i dhënë frenat mendimeve të mia, duke mërzhitur në mendjen time jetën e mëparshme; dhe fillova, dalëngadalë, për të zbuluar gabimet e shumta të zemrës sime dhe për të zbuluar sesa e egër, e ashpër dhe e pavlerë kisha qënë deri më tani. Nuk mund të megjithatë në atë kohë të ndieja pendim, sepse mendoja se unë u linda përsëri; shpirti im hodhi buzët e mëkatit të kaluar, për të filluar një karrierë të re në pafajësinë dhe dashurinë. Asgjë e ashpër apo e ashpër nuk mbeti të ndjejë ndjenjat e buta që transaksionet e ditës kishin frymëzuar; Unë isha si një fëmijë që po i hidhja përkushtimet e saj pas nënës së saj, dhe shpirti im plastik u kujtua nga një dorë mjeshtrë, të cilën as e dëshiroja, as nuk munda t'i rezistoj" (fq 35)

Me përgjigjen e saj, autorja e ngriti veten nga gropa për të vazhduar më tej jetesën, duke u bërë endacake e llojit të saj artistik - Mary Shelley i tejkaloi të gjithë Romantikët, duke kompozuar prozën e bukurisë tronditëse poetike. Jo vetëm kaq, në përgjigjen e saj, mund ta ndiejmë veten edhe shumë prej nesh në këto ditë: duke u përpjekur për të ristrukturuar gjërat, duke u dhënë gjërave një prioritet të cilin nuk ia kishim atribuar më përpara, duke reflektuar mbi shumë aspekte jetësore, etj.

Duke vijuar me romanin, udhërrëfyesi i romanit, Lionel Verney (Djali jetim i një fisniku të varfër) - një i ri idealist, më poroz se shumica edhe për vuajtjet më të thella të të jetuarit dhe bukurinë më transhendente të jetës - është më i afërti i Mary Shelley, stoik dhe i mbrojtur, erdhi duke pasqyruar një autoportret psikologjik. Në paralelizëm me këtë, sa protaagonistë të kësaj natyre mund të kemi në realitetin tonë psikologjik në kontekst jo vetëm kombëtar pro edhe botëror? Bota jonë është e mbushur me persona jetimë, të pastrehë, me probleme të thella socio-ekonomike të cilët vuajnë dhe kërkojnë një busull orientimi në kohë shumë të vështira.

Sipas autores, ndërsa pandemia tërheq botën (ja si shprehjet)

"Mund të imagjinohet se gjërat ishin në një gjendje të keqe në të vërtetë, përpara se kjo frymë e mirëdashjes të mund të kishte goditur rrënjë kaq të thella. Infeksioni tani ishte përhapur në provincat jugore të Francës. Paniku i goditur u shfaq më shumë lëndim, sesa sëmundje dhe shoqëruet të saj natyror. Efektet e pastrimit të ftohjes u ndjenë menjëherë; dhe listat e vdekshmërisë jashtë vendit ishin zvogëluar çdo javë. Shumë nga vizitorët tanë na lanë: ata, shtëpitë e të cilëve ishin larg në jug, ikën me kënaqësi nga dimri ynë verior dhe kërkuan tokën e tyre të lindjes me shumë edhe pas vizitës së tyre të frikshme. Ne morëm frymë përsëri. Çfarë do të sjellë vera e ardhshme, ne nuk e dinim; por muajt e tanishëm ishin

tonat, dhe shpresat tona për ndërprerje të murtajës ishin të mëdha". (fq 312)

Në këto rreshta gjejmë mjaft aktualitete: dëgjojmë lajmet çdo moment, dëgjojmë dhe ndjekim ecurinë e situatës në botë cilat janë vatrat e infeksionit në vendin tonë, duam dhe kemi nevojë të jemi të informuar mbi numrin e të prekurve apo nëse ka prej tyre që janë duke u shëruar. Kur dëgjojmë se kurba e infeksionit po bie, na jep një shpresë në një mënyrë të paimagjinueshme dhe si rrjedhojë neuronet pasqyrë fillojnë të bëhen pasqyrimi i realitetit.

Dhe për tu rikthyer përsëri tek autorja jonë: sipas saj pandemia mposht të dashurit e protagonistit një për një të cilën e shpreh nëpërmjet pasazhit si në vijim:

"Shokët e mi të dashur u alarmuan, ata e shprehën alarmin e tyre me aq ankth, sa që nuk guxova ta shqiptoja fjalën murtaja, që u vu mbi buzët e mia, që të mos ngatërrojnë pamjet e mia të çoroditura në një simptomë dhe të shohin infeksionin në langurën time. I kishte rigjetur zor dhe me hilaritet të hidhëruar i kisha sjellë buzëqeshjet në rrethin tim të vogël" (fq 317)

Le të reflektojmë mbi këtë pasazh: cili prej nesh të mos jetë alarmuar, sa prej nesh mund të kenë ngurruar të shprehin qoftë edhe një shenjë gripale apo alergji të zakonshme me synimin e mirë për të mos alarmuar familjen apo të njohurit tanë. Ndoshta këtu, sërish mund të gjejmë pikat e takimit me udhëtimin e protagonistit siç shprehet në një prej pasazheve:

"Në përgjigje të pyetjeve tona të etur, vetëm një fjalë ra, ashtu siç ishte e pavullnetshme, nga buzët e tij të ngulitura: Murtaja -- «Ku?» - «Kudo ku - duhet të fluturojmë - të gjithë fluturojnë - por ku? Askush nuk mund të tregojë - nuk ka asnjë strehë në tokë, ai vie mbi ne si një mijë pako ujçer - të gjithë duhet të fluturojmë - ku do të shkosh? Ku mund të shkojë dikush prej nesh?" (fq 318)

Në përgjigje të kësaj, ne jemi duke qëndruar në shtëpitë tona, duke mbajtur distancimin fizik, duke u përpjekur që të respektojmë masat universale në bazë të perceptimeve që kemi ngritur për situatën pandemike si dhe në bazë të akteve normative që janë ngritur në mbrojtje të shëndetit human. Mirëpo ky koncepti "kohë" na krijon pasiguri në të siguarit e një përgjigjeje që të na ngrohë. Do të ketë një zgjidhje- këtë pohim ia themi njëri-tjetrit por njëkohësisht e kërkojmë me kërshtëri të madhe nga mjekët epidemiologë dhe ekspertët kombëtarë e botërore të fushës.

"Vërejtjet e tua janë si vetja, e dashur," u përgjigja unë, «e butë dhe e mirë; le të vlerësojmë një besim të tillë dhe ta heqim ankthin nga mendjet tona. Por, ne jemi kaq të formuar, (dhe nuk ka mëkat, nëse Zoti e krijoi natyrën tonë, për t'iu nënshtruar asaj që ai rregullon), ne jemi aq të formuar, që duhet ta duam jetën, dhe t'i përmbahemi asaj; duhet ta duam buzëqeshjen e gjallë, prekjen simpatike dhe zërin emocionues, të veçantë për mekanizmin tonë të vdekshëm. Le të mos, përmes sigurisë në jetën e përtejme, të mos e lëmë pas dore të tashmen. Ky moment i tanishëm, i shkurtër ashtu siç është, është një pjesë e përjetësisë, dhe pjesa më e dashur, pasi është e jona në mënyrë të patjetërsueshme. Ti, shpresa e ardhmërisë

sime, je ti gëzimi i tanishëm. «(fq 446)

Ah ja edhe një përgjigje tjetër e cila na kujton që pavarësisht situatës dhe gjendjeve tona psikologjike, të duam të tashmen e të mos e lëmë atë të na rrëshqasë nga duart. Por sërish, përgjigja na duket më shumë e një natyre emotive sesa asaj racionale sikur në pasazhin e dhënë:

"Ndjenjat e mia të tanishme janë aq të përziera me të kaluarën, sa nuk mund të them nëse njohuritë për këtë ndryshim na vizituan, pasi qëndruam në këtë vend steril. Më duket; se një re dukej sikur kalonte nga sipër nesh, se një peshë merrej nga ajri; që tani e tutje kemi marrë frymë më lirshëm, dhe kemi ngritur kokën me një pjesë të lirisë së dikurshme. Megjithatë ne nuk shpresonim. Ne u mahnitëm nga ndjenja, se raca jonë ishte e drejtuar, por ajo murtajë nuk do të ishte shkatërruesi ynë. Koha e ardhshme ishte si një lum i fuqishëm. Çfarë do të bëhej prej nesh? O për ndonjë orakull Delfik, ose ... për të thënë sekretet e së ardhmes! O për disa Edipi për të zgjidhur enigmën e Sfinksit mizor! I tillë ishte Edipi që unë të isha - duke mos parashtruar guximin e një fjale, por zhurmat e trishtueshme të të cilit dhe jeta e trishtuar do të ishin motorët, me të cilët do të linin të fshehura sekretet e fatit, dhe të zbulonin kuptimin e enigmës, shpjegimi i së cilës u mbyll historia e racës njerëzore"(fq 559)

Eh....Sa e përjetojmë të gjithë këtë situatë...sa të pafuqishëm ndjehemi. Megjithatë përsëri vazhdojnë ditët tona me një mendim tjetër në horizont.

"Megjithatë si mund të jap dorëheqjen? Pa dashuri, pa simpati, pa shoqërim me asnjë, si mund ta takoj diellin e mëngjesit, dhe me të gjurmojë udhëtimin e tij të përsëritur në hijet e mbrëmjes?"

E qartë, ne po qëndrojmë të distancuar: arsimit tashmë po zhvillohet online, shumë aktivitete sociale vijojnë të jenë të pezuluara, shumë aktivitete ekonomike po ashtu dhe kjo na krijon ndjesi të përziera, besime dhe mendime irracionale. Mirëpo, ne i kujtojmë vetes se jemi homo sapienz.

"Më lejoni, me fjalën e parë, «tha ai,» të heq mendjen tuaj nga çdo frikë për llogari të mia. Unë nuk do ta detyroj veten përtej fuqive të mia, dhe as nuk do të kërkoj pa nevojë rrezik. Ndjej se e di se çfarë duhet të bëhet, dhe pasi prania ime është e nevojshme për realizimin e planeve të mia, do të bëj kujdes të veçantë për të ruajtur jetën time" (fq 325)

Vërtet, sikur edhe protagonistin, ne ende i kujtojmë vetes se jemi akoma në këtë udhëtim jetësor. Duke u rikthyer sërish tek protagonistin i Shelley, ai arrin të kthehet në shtëpi për të kërkuar siguri "siç bën zogu i nxitur nga stuhia [në] fole në të cilën mund të palosë krahët e saj në qetësi." Atje, në heshtjen e çuditshme, të zhveshur nga zënie dhe zakonshme dhe shpërqendrimet e ekzistencës shoqërore, ai e gjen veten duke soditur thelbin e jetës:

"Sa të mençur kanë qënë endacakët, të cilët kishin braktisur strehën e [foleve], të ngatërruar në rrjetën e shoqërisë dhe hynë në atë që njerëzit e botës e quajnë «jetë», - atë labirint e së keqes, atë skemë të torturave të ndërsjella. Për të jetuar, sipas kësaj kuptimi të fjalës, ne jo vetëm që duhet të vëzhgojmë dhe mësojmë,

QERIM DELIJA

Qerim Delija lindi në Gimaj të Shalës, në vitin 1830, në një familje të madhe patriotike, atdhetare, me vlera të mëdha të karakterit burror, fisnor e dukagjinas. Kjo derë, brez pas brezi ka gëzuar një respekt të veçantë në të gjithë zonën e Dukagjinit e më gjerë. Deli Nika me të bijtë e tij zëmëdhentë: "Si të bijtë e Deli Nikës!", Çuku, Avdija, Qerimi, Sokoli dukej sikur të kishin lindur nga çarku i pushkës! Kudo, burrat e kësaj dere kanë marrë pjesë në betejat patriotike për mbrojtjen e trojeve të të parëve, për liri e pavarësi të Shqipërisë.

Qerim Delija largohet nga Gimajt e Shalës me familjen e tij, për në qytetin e Shkodrës në kërkim të një jete më të mirë. U vendos me banim në lagjen "Skënderbe" të këtij qyteti. Qerimi, në kërkim të një pune për të përballur jetesën dhe nevojat familjare, vendoset në prefekturë si punonjës magazinimi e sistemimi. Për të gjetur këtë punë në Prefekturë e favorizoi edhe lufta që kishte bërë në kështjellën e Medunit, ku Deli Nika me katër djemtë e tij ishte dekorue nga asqeri turk me medaljen e "Trimërisë". Qerimi ishte I besimit katolik dhe përpiquej të kujtonte ditët e shenjta sipas traditave të të parëve të tij në Shalë, me besimin e madh tek Zoti, në emër të të cilit dha edhe jetën. Një ditë para Natës së Shënkollit, si gjithmonë festohet me 5 dhjetor, Qerimi mendon me u përgatitë për këtë festë sa më mirë. Mendon dhe dëshiron që shtëpia e tij të mbushet plot me miq, ashtu si përherë. Për këtë, vajti tek Valija me i kërkua leje që ditën e nesërme të rrinte në shtëpi, për të festuar festën.

Qerimi hyn në zyrën e Ibrahim Agës dhe I thotë: - Zotni Vali!, - duhet me më dhanë leje për nesër, që të rri në shtëpi, se kam festë e duhet me u përgatitë me festue me familjen time dhe ndonjë mik, që ndoshta vjen në këtë festë të Madhe.

Ibrahim Aga i përgjigjet se, s'mund t'i japë leje, prandaj duhet të shkonte në punë.

Qerimi I përgjigjet:

- Nuk kam si vij, pasi kam festen ma të madhe të dymbëdhjetë muajve të vitit!

Valiu i hakërrehet duke i thënë:-

- Nesër do vish në punë! Po deshe mungo!

- "Pasha Krishtin nuk kam si me ardhë, pasi është Nata e Shënkollit e i 'Paçim ra në dorë!', prandaj mos më prit"-ia kthen Qerimi.

Ibrahim Aga ngrihet në këmbë, me një ulërime të madhe, si tërbuar.

- I drejtohet Qerimit, duke I fyer fenë e Krishtit e Natën e Shënkollit me një çmenduri të pa parë! Qerimi, sedërmadh, përjeton tmerrin më të madh të jetës së Tij. Iu duk sikur gjithë prefektura u rrënuar, tokë e qiell ju përzien dhe Bota e humbi kuptimin. Del nga prefektura. I drejtohet shtëpisë, i ndezur flakë nga zemërimi. Të nesërmen, me 5 dhjetor, ngrihet në mëngjes, merr kafën dhe gotën e rakisë, lëvdon Krishtin dhe i lutet Natës së Shënkollit, që t'ju prijë mbarë, pastaj nis për në treg. Pasi blen dyllin, delen e çfarë nevojitet për festë, kthehet në shtëpi dhe ju tregon familjareve, se çfarë I kishte ndodhë me Ibrahim Agën.

Qerimi iu la një amanet: "Festojeni sa ma mirë Natën e Shënkollit, edhe në qoftë

se nuk vij unë, se due me shkue me takue Ibrahim Agën, pa shkue me ba pushimin e drekës". Armatoset mirë e mirë dhe shkon tek prefektura. Pret në një qoshe për të dalë Ibrahim. Pas pak duket Ibrahim tek po shfaqet tek dera e prefekturës bashkë me zabitin. Qerimi ju del përpara, qëllon pa I bërë syri 'tërr' mbi ta, duke I lënë të vdekur që te dy në vend dhe largohet drejt shtëpisë. Në Saraj u dha alarmi në të gjitha anët, që Qerim Delija të kapet e të sillet këtu. Pasi e rrethojnë me ushtri e kapin në Serreq dhe e çojnë tek Pasha. Pasha merr vendimin për ta internuar në Arabi.

Ja disa vargje që janë kënduar nga populli, në atë kohë:

Vrau Valinë e vrau zabitin

Menjëherë po bien boria

N'sarj na u mblodh ushtria

Ka marre rrugën me shkue te shpija

Ka marrë rrugën prej Serreqit

Para i dalin ushtarët e mbretit

Me ushtri e kanë rrethue

Fill kah pasha e kanë çue

Njat' herë pasha në kambë asht çue

Qerim Delinë me internue

Burg për jetë me burgue...!

Si u vertetue fundi i Qerim Delisë?

- Tregohet nga gojëdhënat e Gjon Ujkës së Planit, i cili po ulej në Shkodër me ba shteg (me ble gjanat që i nevojiten shtëpisë). Gjonit i kishte vra Shkreli një shoq të tij dhe s'ia kishte marrë gjakun. Për këtë njerëzit përdorin shprehjen: Shkosh edhe ti si filani...! - për shokun e Gjonit. Dikush e përdori këtë shprehje dhe Gjoni e dëgjoj. Atëherë u betue, se kurrë s'po kthehem i gjallë pa marrë hak! Zbriti në Shkodër e shkoj tek Kisha e Madhe, dhe pyeti: A kena kanë prej Shkrelit këtu? Po, - I thanë-, është bajraktari i Shkrelit tujë pa meshë në kishë. Gjoni e pret dhe pasi del e largohet nga kisha e vret. Regjimi e arreston dhe e internon, bashkë

me Qerim Delinë, në Tarabollus të Libisë. Gjoni ka tregue se i kanë tretë dhe i kanë lan të lirë. Ka tregue, se në atë vend kishte njerëz të mëdhenj e quheshin 'katallan'. Ai ka pohuar, se kanë dalë e lypë për bukë nëpër shtëpia për të ngrënë, dhe një ditë më kujtohet, se na kanë dhanë bukë me një dorë fëmije sipër saj. E kena marrë dhe dorën e kemi tretë, kemi hjekë koren e bukës dhe pjesën tjetër e kemi hangër. Kemi nejt disa kohë njashtu pa ditë gjuhë, pa vatan, veç si zogu; ku na zinte nata e na zbardhte drita! Dikur, na kanë kapë e na kanë çue në Anadoll, në një shtëpi katërkatëshe. Aty kemi nëjt gjashtë vjet bashkë. Një ditë Qerimi më thotë:

- A e bajmë një punë?

-Çfarë?- ju përgjigja unë.

- A kërcejmë nga dritarja, në shpëtofshim mirë; në mos shpëtofshim s'ka problem, por këtu nuk rrihet ma!

Unë ju përgjigja: - Unë nuk jam tujë kërcye!

Ai ka thane: - Unë jam ka hidhem, pasi jam i denuem për jetë. Këtu nuk më rrihet. Nuk e duroj ma këtë lloj jete.

- Ai është hedhë nga dritarja duke I dhanë fund jetës së tij.

Gjon Ujka ka nëjt edhe tri vjet në burg, pastaj është liruar dhe ka ardhë në shtëpi, duke treguar jetën, vuajtjet dhe si është bërë puna e Qerim Delisë.

Në këtë histori kaq të dhimbshme gjen vlerat e mëdha, virtutet e pashoqe, njeriun e madh të veshur me traditat më të spikatura të zonës si besimin, bujarinë, trimërinë, atdhetarin dukagjinas, për të cilin luftoj gjithë jetën dhe i dhuroj famë historike me aktin e tij sublime.

Djemtë e Deli Nikës ishin: Cec Delija; Sokol Delija; Qerim Delija; Çuk Delija; Prel Delija; Avdi Delija; Nue Delija.

Lavdi u kjoftë jetës dhe veprës së tyre!

Martin SOKOLI (SKOLLAJ)

duhet të ndiejmë gjithashtu; nuk duhet të jemi thjesht spektatorë veprimi, duhet të veprojmë; ne nuk duhet të përshkruajmë, por të jemi subjekte përshkrimi. Trishtimi i thellë duhet të ketë qenë burgosja e gjirit tonë ... dyshimi i sëmurë dhe shpresa e rremë duhet të ketë zënë ditët tona ... Kush që e di se çfarë është «jeta», do të binte për këtë specie të ethshme ekzistence? Kam jetuar. Kam kaluar ditë dhe netë festash; Unë jam bashkuar me shpresë ambicioze ...: tani - mbylli derën botës dhe ndërto lart murin që do të më ndajë nga skena e trazuar e krijuar brenda zonave të saj."

Në pajtim me Whitman - "Pasi të keni shteruar atë që ekziston në biznes, politikë, bindje, dashuri, dhe kështu me radhë - nuk keni konstatuar se asnjëra nga këto më në fund nuk ju kënaq, ose vesh përgjithmonë - çfarë mbetet?" autorja do të pyeste nëpër hapësirë dhe kohë, pastaj do të përgjigjet: "Natyra mbetet". - Protagonisti i Shelley gjen kuptimin e jetës jo në vorbullën e botës së krijuar nga njerëzit me simulakrën e tij të jetesës, por në praninë e thjeshtë krijuese me simfoninë e vazhdueshme të jetës:

"Le të kërkojmë paqe ... pranë murmuritjes së lumenjve në brendësi të tokës, dhe valëzimin e pemëve të hijshme, rrobat e bukura të tokës dhe rrëfimin sublim të qiellit. Le ta lëmë «jetën» që të mund të jetojmë."


Në kulmin e pandemisë vdekjeprurëse, natyra duket gjithnjë e më e vendosur për të afirmuar rezistencën e jetës - pranvera arrin me shpërthimet e saj të papërmba-



Mary Shelley. Art nga *Literary Witches* - një festë e ilustruar e shkrimtarëve gra mbresëlënëse të grave që kanë magjepsur dhe transformuar botën.

jtshme të bukurisë, të pakontrolluara nga vuajtjet njerëzore dhe një kurim suprem për të. Është duke vëzhguar deliriumin e pakufishëm të natyrës në shprehjen e tij më të ngushtë, duke u dorëzuar në spastrimin e saj, që Lionel rimerr besimin e tij jo vetëm në mbijetesë, por në bukuri, në denjësinë e jetës. Shelley shkruan:

"Dimri ndërroi jetë; dhe pranvera, e udhëhequr nga muajt, zgjoi jetën në të gjithë



naturën. Pylli ishte veshur me jeshil; viçat e rinj të skuqur mbi barin e ri të mbjellë; hijet e krahëve me erë të reve të lehta që përshkojnë fushat e gjelbërta; vetmitari kuko përsëriti gjithë breshrin e tij monotone për sezonin; bilbili, zogu i dashurisë dhe minioni i yllit të mbrëmjes, mbushnin pyjet me këngë; ndërsa Venusi binte në perëndimin e diellit, dhe jeshilja e re e pemëve shtrihej në një lehtësim të butë përgjatë horizontit të qartë."


Nga kjo prani e hapur me botën jo njerëzore, protagonistin i Shelley nxjerr thelbin e asaj që do të thotë të jesh njerëzor:

"Ka vetëm një zgjidhje për enigmën e ndërlikuar të jetës; të përmirësohemi, dhe të kontribuojmë në lumturinë e të tjerëve."

Dhe ja kemi mbërritur në fund të këtij reflektimi. Teksa përmbyllja romanin e lexuar, autorja thekson e shqetësuar: Kush do ta lexojë, kujt ia kushtova këtë libër ... dhe me shkronja shtypi ka shkruar Kush-tuar "NJERIUT TË FUNDIT"..Dikush do e lexojë sepse i drejtohet njeriut që mbijetoi. Ndoshta e njëjta pyetje më pëshkroi edhe mendjen time: kush do ta lexojë këtë reflektim timin? Kujt ia kam kushtuar? Beh... ndoshta se unë e ndjej se ka filluar të trokasë stina e pranverës..Ndoshta edhe do të ketë ndonjë kurioz sa ta rilexojë romanin. Kujdesu për veten, udhëtimin tënd dhe atë të të tjerëve. Ndodhemi në të njëtin ishull botëror në të cilën jeta e njeriut është në pikëpyetje.Atëherë le të provojmë marrim me vete këtë pasazh të fundit të Shelley:

"As shpresa, as gëzimi nuk janë pilotët e mi - më udhëheq dëshpërimi i shqetësuar dhe dëshira e ashpër dhe ndryshimit. Unë kam dëshirë të emocionohem nga frika, të kem ndonjë detyrë, sado të vogël ose të vullnetshme, për përmbushjen e çdo dite. Unë do të dëshmoj për të gjithë larminë e pamjes, që elementet mund të supozojnë - Unë do të lexoj një urim të drejtë në ylberin - një kërcënim ndaj reve - ndonjë mësim ose regjistrim i dashur për zemrën time në çdo gjë"(fq 615).

MARASH KOLA ËSHTE NGA ATA PERSONALITETE, QË JETON EDHE PAS VDEKJES



Që nga sot nuk do ta kemi më midis nesh të mirin Marash Kola. U lind më 13 korrik 1931 dhe u nda nga jeta më 31 mars 2020. Ai u lind në Lotaj të Shalës, në një familje me tradita të larta për të cilat punuan në të gjitha kohërat dhe për të cilat punoi edhe vetë Marashi deri sa u nda nga jeta, pavarësisht se ishte në angazhime zyrtare në nivele të larta. Marashi ishte nip në shtëpinë e Bashë Vatës në Shtëpinë e Lul Gjokës në Gjellaj të Thethit. Ai i deshti gjithmonë, asnjëherë nuk qëndroj larg edhe pse puna e largonte, por vazhdimisht komunikonte në mënyra të mundshme. Edhe kur nuk kishte mundësi për të marrë pjesë në momente të veçantë të familjarëve dhe të afërmeve, asnjëherë nuk harronte, që në mundësinë e parë të bënte vizita për të bërë urime apo për të bërë ngushllime, cilësi kjo shumë e mirë. Ai u nda nga jeta nën përkujdesjen e pakursier të bashkëshortes, Lena, djemëve dhe rejaeve, nipërve dhe mbesave.

Marash Kola ishte një djalë shumë vepërimtar që në rininë e hershme të tij. Nuk u kursye për të mirën e fshatit, krahinës dhe të gjithë vendit. Çlirim i Shqipërisë e gjenë në moshë të re. Kishte dëshirë të madhe për shkollë dhe megjithëse me vështirësi ai nuk i ndahet shkollës dhe merr njohuritë e nevojshme. Shumë shpejt u angazhuan në detyra të kohës në fshat e zonë, veçanërisht në punën në rininë. Në moshën 17 vjeç, megjithëse i ri, fillon punë në ish Rrethin e Dukagjinit Dhe, që nga ajo kohë, gjithnjë në detyra pothuaj në të gjithë vendin, që nga Dukagjini e Puka, Tirana, Dibra e deri në Korçë e Gjirokastrë, e duke u ngjitur deri në rangje të larta të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në fillim të viteve '50 bashkëpunon shumë mirë me axhën tim, Ndoc Prelë Shytin, i cili në atë kohë ishte instruktor në Komitetin e Rinisë së Qarkut Shkodër, veçanërisht në organizimin e brigadave vullnetare të rinisë për rindertimin dhe ndertimin e vendit të

dalë nga lufta, por edhe më tej me ndertimin e tij. Më vonë Marashi ngarkohet me detyrë në rrethin e Pukës e në vende të tjera, ndërsa Ndoci pas pak kohe vdes nga një sëmundje e rëndë e pashërueshme.

Me punën e tij shumë të mirë, Marash Kola, arrinë të plotësoj arsimin përkatës dhe dërgohet jashtë shtetit, në Moskë për të studiuar, por edhe pasi u kthye suksesshëm prej andej, përsëri mbaroj edhe një fakultet tjetër në Shqipëri. Puna me përkushtim e bëri të kërkuar dhe të mirëpritur në punë, veçanërisht, në frontin e luftës kundër krimit, ruajtjes së pronës dhe itegritetit e Shqipërisë.

Marash Kola punoi me të gjitha fuqitë e tij mendore dhe fizike kudo që ju kërkua. Në detyrat që ju ngarkuan, ai, e dinte se nuk ishin fushë me lule, por ishte me shumë probleme dhe që kërkonin kujdes, vëmendje dhe vullnet, cilësi këto që kurrë nuk i munguan Marash Kolës. Ai i shërbeu ligjit me të gjitha mundësitë dhe njohuritë e tij. Në të gjithë punën e tij kishte në plan të parë edukimin, bindjen dhe në pamundësi të tyre duheshin marrë edhe masa të tjera pastaj. Për këtë që krenar dera sa mbydhi sytë përgjithmonë, dhe për këtë u vlerësua në të gjithë kohërat, nuk la dashakëqij, pavarësisht nga detyrat që ka pasur. Kjo tregohet edhe nga shumë prej atyre që e kanë njohur, madje edhe nga ata që ishin përballur me ligjin e kohës. Ai mbylli sytë krenar për punën e tij prej 72 vitesh në punë dhe pension, që askush, nuk pati mundësi ti shtrijë gishtin për keq. Në vitin 1953 Marashi krijon familjen duke u martuar me Lenën, të cilët linden tre djem dhe i rriten me shumë dashuri. Ata i ushqyen përherë me dashurinë për mirësjelljen, shkollën, punën, me dashurinë për vendlindje, për atdheun dhe të tillë u bënë. Lena i qëndroj Marashit pranë gjatë gjithë jetës së saj plot dashuri e mirësi.

Marash Kola kurrë dhe për asnjë çast nuk u shkëput me mendje dhe zemër nga vendlindja e ti, nga Lotaj, Shala dhe Dukagjini, për ta u interesue në të gjitha mënyrat e mundshme edhe nga larg edhe nga afër. Marashi la pas kujtime shumë të mira, por nuk qe e thënë që jeta e tij të kalojë lehtë, veçanërisht në fushën e detyrës që ushtronte. Pas vitit 1990 u dënua nga gjykata e kohës, porse pas pak vitesh gjykata i jep pafajësinë. Kjo ja lehtësoi "plagën" e madhe që politika i hapi. Ai ishte i bindur se ishte politika që e çenoi në atë mënyrë, por më në fund mori pafajësinë.

Një pjesë të punës, fitoreve, vështirësive, kënaqësive, Marashi, i përmbodhi në kujtimet e veta të shkruara me shumë dashuri e ëmbëlsi të cilat tashmë janë në qarkullim. Marash Kola, kudo që shkoj dhe punoj nuk i doli asnjë herë jashtë mendjes vendlindja, Dukagjini. "...kudo që shkova me punë ose studime, deri në Moskë, dashuria e malli për Dukagjinin më kë në pushtuar të tërin", shkruan Marashi në kujtimet e tij. Unë mendoj, vazhdon Marashi "...se sa më larg t'i qëndrosh vendlindjes, për shkaqe nga më të ndryshme qofshin, më shumë të ndizet si flakadon dashuria dhe malli...". Ai ndjen keqardhje për mos kujdesin e treguar nga shteti dhe qeveritarët për Dukagjinin "...me emër të madh dhe vlera të shumanëshme, në këto vite tranzicioni të vështirë dhe braktisur nga shteti me moskujdesje, nga qeveritë, të majta dhe të djathta qofshin". Ai nuk harron edhe mesazhin për lexuesin dhe sidomos për brezin e ri dhe ata që vinë se: "Kudo që të shkosh nëpër botë dhe çfardo posti që të mbash, nuk ka vend më të dashur për ty, se sa vendlindja". Si njeri i kulturuar, por edhe duke pasur parasysh vështirësitë që ka pasur për tu shkolluar, dhe rezultatet që ka pasur, ka qenë gjithnjë i interesuar dhe këmbëngulës për shkollimin e fëmijëve dhe përparimin me rezultate sa më të mira. Ata jua shpërblyen prindërve të tyre duke u arsimuar të gjithë, Deda në fakultetin ekonomik, Vata akademinë e arteve në Londër, Sokoli u specializue pas shkollën teknike për ndërlydhe ku punon edhe sot. Në kujtimet e tij tregon me nostalgji për pritjet dhe përcjelljet për prindërit e tij të dashur. Edhe, Bora, mbesa e Marashit, që 12 vjeçe, kur pyetej se nga ishte me krenari thoshte: "Jam nga Lotajt e Dukagjinit". Natyrisht që ishte një dëshirë e gjithëshme e Marashit dhe Lenës për të mos harruar vendlindjen dhe prejardhjen që i bënte krenar. Në një shkrim

të disa viteve më parë Marashi shprehej prerë: "Jam i mbushur me plot krenari për Dukagjinin...".

Megjithë largësinë e punës nga vendlindja, prindërit e Marashit, Kola dhe Pashka, megjithëse djalë i vetëm, nuk e ndjen largësinë aq shumë duke pasur parasyshë distancat, por fliste në ata mjete të kohës, vinte e i vizitonte, i merrte në shtëpinë e tij dhe qëndronin sipas dëshirës, interesohej për shëndetin e tyre, kujdesej për mjekime apo ilaçe, deri edhe në përcjelljen për në banesën e fundit.

Krahas punës jo të lehtë që kishte dhe përkushtimin për të, Marashi, gjentë kohë edhe të për të shkruar në shtypin e kohës që më 5 maj 1954, që shkruante në gazetën "Zëri i Rinisë" për mësuesen e parë dukagjinase Shkurte Rusheten (Ara). Kështu shkrimet vazhduan edhe në "Zëri i Popullit", Revista "Në shërbim të popullit", por punën në lidhje me shtypin e vazhdoj edhe pas daljes në pension. Shkroi në gazetën "Standard", "Koha Jonë", gazetën "Dukagjini" të cilën e donte si diçka shumë të dashur dhe të veçanta, etj. Ai ndjehej krenar dhe par asnjë rast nuk mohoj punon dhe rezultatet e arritura por edhe vështirësitë e hasura rrugës, në jetën e tij.

Marash Kola, u nda nga jeta, por la emrin e mirë, punën e mirë, mirësinë, kudo jetoj, ku kaloi, e ku punoj. Për Marashin kishim nevojë përsëri ta kishim midis nesh, për fjalën e tij të urtë dhe të mençur, për thellësinë e mendimit, për çiltërsinë e gjykimin, për drejtësinë e vendimit, por jeta kështu e ka. Për Marashin do të ndjejnë mangësi familja dhe të afërmit, shokët e miqtë e shumtë të tij, edhe rrugës do të mungojnë hapat e tij të qetë dhe të sigurtë, do ti mungojnë tavolinës e sofrës, do ti mungojnë rrethit të burrave, do ti mungojnë intelektualëve të përkushtuar, lapsi i tij i mirë do ti mungojnë letërës.

Posho i qetë, Marash Kola, o shok, o nip, o mik, se detyrën tënde e bëre me përkushtim dhe mbydhe në mënyrën më të mirë të mundshme, posho i qetë se pasardhësit tuaj jo vetëm do të kujtojnë me dashamirësi e respektin prindëror, por do ta ngrënë më lartë emrin tënd dhe të familjes tuaj të shkëlqyer.

Lum ai që jeton edhe pas vdekjes. Marash Kola, me punën, me zemrën, me mendjen e tij, është njëri prej tyre.

Luigj SHYTI, Prill 2020

NDAHET NGA JETA DOM MIKELE BRAGA

- Një nder meshtarët më të rëndësishëm të Dioqezës "Shkodër-Pult", sekretar i imzot Frano Illisë, i cili punoi për 21 vite në Shqipëri -

Lajmin për ndarjen nga jeta me date 30 mars 2020 e dha Imzot Masafra, gjate një interviste në radio Vatikan, i cili vlerësoi punën dhe jetën e këtij meshtari.

Dom (Michelangelo) Mikele Braga lindi më 18. 12. 1939, në Brescia (Itali). U shugurua meshtar më 11. 06. 1966 (ishte anëtar i Kongregatës së Oratorit së Shën Filipit deri në vitin 1969).

Për disa vite ishte zëvendës famullitar në disa famulli.

Më vonë, gjatë viteve 1982-1993, ishte famullitar në Palazzolo.

Në vitin 1992, Imzot Frano Ilia, gjate disa vizitave mjekësore në Brescia, u njoh me dom Mikelin, të cilit i bëri ftese që të vije në Shqipëri, se kisha katolike kishte nevojë te mëdha për meshtar e ndihme financiarë, për ngritjen e strukturave të kishës katolike. Dom Mikeli pranoi ftesën.

Gjatë viteve 1993-2014 shërbeu si Meshtar dhe Sekretar i Imzot Frano Illisë dhe famullitar në Shllak, Koman e Juban. Puna e tij tepër aktive, u karakterizua si misionar, duke u gjendur pranë njerëzve në përcjelljen e fjalës së Zotit, duke dhënë sakramente në çdo situatë që kërkohej, në spitale e në shtëpi. Banoret e Shllakut kujtojnë me respekt këtë misionar me shpirt të madhe, i cili duke pare nevojat e mëdha, që kishte shkolla e mesme, solli në një kohe rekord banka, tavolina, stufa për ngrohje, fletore e mjete didaktike.

Dom Mikeli ndihmoi në mjaftë familje duke ju dhënë ushqime e veshmbathje. Me aftësitë e një misionari të rëndësishëm, siguroi ndihma tek bamirësit katolike në ndertimin e kishës në fshatin Bene të Shllakut.

Me ndarjen nga jeta të Imzot Frano Illise, ka kaluar si famullitar në famullinë

e Shën Prendes, në Juban. Fale aftësive të tija arriti të ndërtojë kishën e ambiente social -kulturore të barabarta si në vendet më të zhvilluara, sjelljen e mjekeve nga Italia për mjekimin e popullsisë dhe ngritjen e një qendre fizioterapie bashkohore.

Një ndihme të veçante dha për shkollimin e fëmijëve, që nuk kishin mundësi shkollimi dhe ndertimin e shtëpive të banimit për familje me probleme të mëdha sociale. Në vitin 2014 largohet nga Jubani në Brescia. Ishte meshtar bashkëpunëtor në Marone e Vello deri në vitin 2017.

Vitet e fundit i ka kaluar në qendrën e të moshuarave Mons. Zani në Bienno në Brescia. Gjithmonë mes shokëve, miqve të ngushtë ka pasur dëshirë të varrosset në Shqipëri. Ka ndërruar jete pa mbushur një vit nga vdekja e vëllait, Silvio Braga, i cili



ishte meshtar në Shqipëri. Dom Mikele u përcjellë pa meshe të posaçme për shkak të covid-19, duke u varrosur pranë vëllait e familjareve në Sevelina. Një meshe për shpirtin e tij është dhënë nga Imzot Masafra në selinë e Ipeshkvise Shkodër.

Shume besimtare janë lutur për shpirtin e tij.

Zoti e paste në Parrise!

Shprehe ngushëllime me te thella për te afërmit: Gjon Nd. Podia, Kol Gj. Kodra, Kol Kumbulla,

Mirash Lumi, Ndoc Livadhi, Zoje Shpendi, Luce Nd. Selimi, Tom Shpendi, Mrika Deda, Gjergj Zojza, Terezina Lorenci e Zef Nika.

Punoi për gazetën "Dukagjini",
Zef NIKA

SHQIPE ILIRE, NANA E FATOSAVE TË AMSHUAR QË LINDIN E NUK VDESIN!

Mustafë Pasha mbasi bjerrti luftën në Babunë u strehë në Kosmaç. Sadrazemi hyni në Rozafat. Dinastia e Bushtalive ra, por nuk u shuan ambicijet e Mustafës për të rifitue kështjellën stregjyshore. Për tu ngjitur i duhej ndihma e gozhupanave të maleve. Ata i kishin dhanë dorën Mehmet Plakut të përzinte Begollajt nga Shkodra. Kara Mahmudi, Lekët i pati mburojë triumfesh dhe viktime të pabesishë së t'brit Ibrahim. As ky hedreq nuk i deshti ma fort se krypën në sy, por erdhi dita me ju duket boll të mirë.

I çoi fjalë Malësisë së Madhe tu i pickue në damarin që shkulma valon.

-Ku jeni stërnipat e Lekëve të motit?! Ku jeni zjarri dhe flaka e maleve të pa nanshtueme? Ku jeni orëmëdhenjt e maleve të mëdha?

Dera e parë e tanë Vilajetit po ju thërrret të bashkohemi shqiptarisht! Si gaca me kashtën luajti edhe sedrën e Dukagjinit.

- O shqipe të moçme mbi kreshta! O fatosa të kenduem në kangë bylbylash. Dera e Bushtalive prej fisi e gjaku të Lek Dukagjinit ju thërrret!

- "Ku je em vëlla se edhe lumi tretë e shteron, por gjaku nuk shpëlahet as s'ndahet! Ashtu si gjyshi em i përndritur do jem Valiu i malit, fushës, myslimanëve e katolikëve vllazën me gjak arbnorë."

Shkodra ka lidhë besë, asht një e pandame me mue me i ra një trame anmikut.

Në ditën e caktueme prej kreshtave ma vigane shqiptare ortiqet shungulluan tu ça qafa e male.

Fatosat e rrebtë, që lirinë e lanë bjeshkëve zbritën n' Shkodër për ta çlirue prej anktheve të zgjedhës së zgjatun barbare. Me

britma batore Dukagjini kah Drishti e krahu i majtë i Kirit fil-loi mësymjen. Nga krahu i djathtë dhe Tepja. Hoti i printe Malësisë tu gjuajt me topa akulli mbi kazemat e ushtrisë osmane.

Te Gomna Harapit, në atë xhungël të egër u përplasjen "mali akullit", me "vulkanin Haëaii". Shtëllungaja tymtore mshehi qiellin mbi qyete me çarçaf të zi reshë sa askund nuk dukej diell as hanë. Loja e akullit me zjarrin vazhdoi gjatë. Nga fundamenti i zemrave të dy ushtrive shpërtheu një llavë zjarrtë gjaku që përskuqi Kirin dhe Drinin. Malësorët shtinin, këndonin e thërrisnin:

- Shkodër nadja e mirë! Çohu në kambë burrneshë e dili zot vetit se qe ku jena! Mustafë Pa-sha dil e shihi krushqit e maleve?!

Askush nuk përgjigjej, as kush nuk shihej në derë e jashtë, heshtje, vetëm heshtje a thue se askush nuk merrte frymë. Malësorët në flakë plumbash pëvesin shoqi-shoqin

-Ç asht ky trishtim i plogësht?! Çka asht kjo ligshiti memece?

-Asha zotën asht tradhti burra!

-tha Kolë Hoti përzhitun nga flaka e një mortaje që i fishkulloi në rrazë veshit.

-Eh Mustafë, Mustafë kjos marrue, nise luftën në Babunë, more lirat dhe e le në mes.

Sot thirre malet në "dasëm" kurse vetë dole e trete!

-Po flet randë pasha bukën;

- ia priti Deli Bajraktari

-Hamdreq ca paça foli hakun lik përmjet;

- shtoi Lec Kacoli tu ju ba krah Kolës

-Bajraktar, ti e Mustë Pasha e bajshi në atë jetë gjakun që po derdhet sot në këtë gropë të zezë Shkodre. Mustafa n'pastë marrë rshat prej Sadrazemit nuk ka si len

kumbarën pa hise!

-Lec Kacoli sot kjos falë! Shazotën të ishte ditë tjetër më vjen te rruga për ç'ka fole. Delia nuk ngjye ku nuk duhet. Në mbledhje, kuvende, usulle shkoj se kam flamurin, por vegël e askujt as nuk bahem pa dekë.

-Nuk e pata fjalën me ranue ty bajraktar, por pashallarët dhe bejlerët banjë si burrecat t'liq me gratë. Ditën i thonë: shakë e gabele dhe natën në terr i shkojnë të bishti e pajtohen. Mustafë Pa-sha dje e ka gërگا Sadriazemin, mbramë i ka marrë verdhoçkat sot ka tretë tu nejtë me "Trashen"!

-Unë jam me ju në një lloguer. Jetën, vdekjen dhe nderin bashkë i këna.

-Fole mirë Deli Bajraktari, të lumë goja - tha Gjokë Kastrati. -Na po luftojmë për nderë të armeve tona jo për Mustafë Pashën! Në na pastë pre preftja Zoti orën. Njerëzit nuk kanë dashuni të barabartë as për atdhe, as për Zot! Edhe nanën nuk e duen barabar të gjithë fëmija. Malet janë Nanëlokja e vatanit dhe vetëm Nana nuk din me ba dallim ndër fëmijët saj...

Përballë një artilerie të pa përshkueshme, në thumb pushkësh të mira të përdoruna nga duar të stërvitura mjeshtërore. Mbas disa orëve dyluftimi drithërues në radhët e malësorëve filloi me u herrë baruti e fishekët. Tu pritë ndihmë, por askush nuk luejti vendit, atëherë menduen të tërhiqen. Me epërsi në ushtarë e armatim me shpinë të sigurtë prej shkodranëve që flinin, turqit erdhën tu e ngushtue vijen e frontit kundërshtar. Malësorët duhej të ishin tërheq ma parë mba-si kur ia nisën u krijue një rrokopujë e rrëmu-jshme. Reshit Pasha, gje e vjetër mejdanesh i goditi me tërbim artilerie mbas shpine. Shumë hotjanë, shaljanë, kelmendas shoshjanë e kastratas, pultinas, u plagosën ranë, se nuk mund u tërheqën dhe të gjithë kaluen nan shpatë...

Në atë vorbull te tmerrshme, një flurudhë plumbi, ardhun nga pas një xhufkë poshtë Qafës se Hardhisë përshkoi kopaçin anës së majtë të Gjokë Shkreli. Ai u mënjanue si lisi që shkulë moti, u shterngue fort të mbahej, por kambët e tradhtuan e u kap në një degë shelve dhe mbeti varun mas saj. Tahir Kurti kthehet turr e vrap me e marrë në shpinë dhe merr një kokërr shyte në baluke që ia fluturoi në ajër kapaçin e rrakakes. Dy burra nga ma t'dokës, ma trimat, ma t'fisëm e ma të njoftun që kish paria i vrau reja flakë për flakë

Gjeka i lamë në gjak nuk bante as eh as oh! Tu e pa shokun e flijuem aty pranë, u ngreh zvarrë në bërryla e ktheu të vdekunin mbarë dhe i tha:

-Të kjoftë e lehtë ledina Tahir o vëlla! Disa shkodranë, ushtarë të Sadriazemit që ja nihnin vlerat, ju lutën eprorit tu i thanë:

- Pashë amanetin falja jetën këtij trimi. E njehtan zotnihanja e Shkodrës. Asht tërvesa dhe ndera e Malësisë së Madhe. Fale se nuk asht i kshtenë. Për fajin e bamë ka boll një kambë të thyeme!

-Me e pa kënkë marshallah, marshallah, turk e hamdyrylah!

-Si e ke emnin o turk i mirë. Ç'taksirat te ka zanë me u rebelue kundër hyqymetit?

- Thashë nuk po vdes pa me nxe një diell Shqipnie. Qebesa me kokë e pa kokë emnin e kam Gjokë! Ma mirë po vdes me nderë me njet emën që kam qysh se leva se me jetue i marruem e pa emën!

Lum ai djep i artë që të përkuni të k'tillë fatosa lule gjaku në detin e zjarrtë të endrrave heroike!

O shqipe Ilire, Nana e fatosave të amshuar që lindin e nuk vdesin!

Fatosat e k'tillë lule gjaku!

Prele MILANI

NE E PANDEMIA

Njerizimi ka përjetuar në shekuj pandemi kontinentale, madje edhe botërore, të cilat kane marre me miliona jete njerëzish të pafajshëm. Po të kthehem në shekuj prapa. Ne lexojmë të regjistruar disa pandemi, siç janë, në vitin 1720 me pandeminë e murtajes. Po, një shekull më pas, në vitin 1820 vjen pandemia e kolerës, duke u pasuar nga gripin spanjoll të vitit 1918-1919. Dy pan-demitë e para morën respektivisht rreth 100 mije jete njerëzish nga të dhënat zyrtare. Kurse gripin spanjoll preku 500 milion njerëz dhe ka shkakuar 50 milion viktime.

Duke u ndale te këto statistika dhe te pandemia, të cilën po e përjetojmë në këto moment, të linte mendimi, se këto pandemi përsëriten çdo 100 vjet. Njerizimi sulmohet shpesh, por jo të këtyre përmasave.

Në kujtesë kemi gripe të ndryshme si gripi i shpendëve, i derrave sarasi e të tjera. Por covid 19 na detyron ti harrojmë ato për nga përmasat që ka marre dhe të pabesia e tij. Le të kthehem, në ditët e sotme se si covid 19 ka pushtuar gjithë botën. Shifrat janë alarmante. Periudhën, kur filloje e deri tani ka arritur në 2.5 milion të prekur, nder këta 160 mije kane humbur jetën. Dhe piku do jete i largët. Shumë më e largët. Sipas shkencëtarëve do jete koha kur do të zbulohet vaksina. Njerëzit të shpëtojnë një here e mire nga covid-19.

Media arrin deri aty, sa pyetet a ka ndonjë dokument për tre pandemitë e kaluara këto 300 vitet e fundit? Pse shkencëtarët nuk japin mendime para se të ndodhemi në katastrofe epidemiologjike? Bota të jete më përgatitur, se të gjithë udhëheqësit thonë, na zuri të papërgatitur! Vonuam në marrjen e masave, prandaj nuk kishim maska, doreza, detergjent me baze alkooli. Nuk po themi, për aparate respiratorë, të cilat duheshin një pjese të ishin rezerve pranë spitaleve. Një metode për parandalimin e përhapjes të kësaj flame shumë të rrezikshme

është distancimi social. Metode e përdorur para 700 vitesh, në mesjete. Ne themi, dhe është e vërtet se shkenca tash 700 vjet ka ecur shumë përpara. Janë bere zbulime të rëndësishme, madje po arrihet deri në planet e tjera. Po, në mjekësi kur do ndërhyhet, për të zbuluar vaksina e barna për të mbrojtur e kuruar njerëzit nga këto pandemi?! Të zbrisim me këmbë në toke. Aktualisht, në vendin tone nga qeveria është marre seriozisht situatë, thonë se kishte mundësi për më mire dhe e mira nuk ka fund. Deri tani në Shqipëri, zyrtarisht janë të prekur nga covid 19 584 persona, të shëruar 327 persona, ose 56 përqindje, dhe kane ndërruar jete 26 persona.

Po janë disa problem, të cilat duhesh bërë më shpejte. Në mes shumë të tjerave themi, prodhimi i maskave artizanale. Fasonet e rrobapësisit duhej detyruar të prodhojnë maska kundrejt pagesës. Kjo është gjendje e jashtëzakonshme dhe askush nuk munde ta kundërshtonte një urdhër të tille, duke ndaluar disa spekulant, të cilët rritin çmimet e maskave e të detergjenteve. Në farmacitë to-na, të cilat kane lulëzuar si kërpudhat pas shiut, bënë një gjeste të shëmtuar, duke rritur çmimet për produktet e emergjencës. Nuk dua të ndalemi te mjekësia, të cilën unë nuk jam i fushës. Por edhe ne si qytetar të këta vendi, duhet zbatuar ato çfarë sugjerojnë epidemiologët e specialistët e shëndetësisë. E jo ne, me fudullëkun tone, të marrim pjese në grumbullimet, për gëzime e hidhërim. Si munde të behën vizita për festen e Pashkëve, aq më keq të grumbullohem si në kohe normale, të thyejmë edhe vezët e kuqe, simbol i kësaj feste. Çfarë munde të themi, pasi në rastet e morteve grumbullohen me dhjetëra e dhjetëra njerëz për ngushëllime. Madje rrinë për dreka e darka! Kujt i bien ndesh këta "trima"? As kujt, për veç familjeve të veta, të afërmeve edhe lagjes ku banojnë. Madje, askush nuk janë më të rrezikuar se gjyshërit e baballarët e këtyre personave. Këto dite duhet të lihen në një ane tradita e burrëria, se kësaj të

shkrete burrëri nuk i del asnjëherë koha. Pra, duhet të ndërjegjësohem se distancimi, qëndrimi brenda në banesa, higjiena personale e shtëpiake e të tjera, është masa më e plote për t'u larguar nga infeksioni. Sot, kjo është burrëria e trimëria dhe jo të shkojmë në një gëzim apo hidhërim me 50 apo më shumë pjesëmarrës. Shumica e njerëzve po ndërjegjësohen në mbajtjen e dorezave, maskave, syzeve e të tjera. Megjithatë, po ka plote "trima apo trimëresha", të cilët nuk zbatojnë asnjë mase të rekomanduar nga specialistët e shëndetësisë, madje edhe tallen me ata, që i mbajnë këto pajisje. Këtu, mendoj se duhet të gjobiten të gjithë ata, të cilët lëvizin pa maska e doreza, pasi tani ato gjenden në të gjitha farmacitë. Po me gjobe duhet te vendosen edhe ndaj atyre, të cilët nuk mba-jnë distancën në lëvizje apo në pikat e furnizimit.

Nuk është ndonjë sakrifice e madhe të qëndrosh në banese. Distancimi social është provuar para 700 vitesh dhe ka dhënë efektet e veta. Tani në shekullin XXI, kur ka mjek e barna, megjithëse, ne përsëri vuajmë, se shkenca ende nuk e ka të qarte, se nga vjen ky virus, që duhet deri tani ta kishte përcaktuar plotësisht dhe të përcaktohen barnat përkatës e të tjera.

Po, unë do ndalesha te një fenomen tjetër: Në një medie ndoqa të kompozitorin Osman Mula, e cili krahas të tjerave e vuri theksin te distancimi social. Madje edhe te qëndrimi në banesa, në sit-uatën e tanishme është domosdoshmëri. Ka ardhur koha theksoje: "Njerëzit të behën më të dashur, më të bashkuar, më tolerant e të mendojmë se gjakmarrja ka mbylle brenda djem të sapo lindur dhe janë bere 20 vjeç, pa e pare dritën e diellit. E pse?! Se ende sundon Kanuni, të cilit i ka kaluar çdo limit kohor. Madje duhet mbajtur si relikte e historisë".

Sipas statistikave, 704 familje janë të prekur nga gjakmarrja, prej këtyre 511 familje jetojnë në Shqipëri dhe 113 familje janë detyruar të lenë vendin e të jetojnë në shtete të tjera, vetëm e vetëm nga frika e gjakmarrjes!! Vetëm

në Shkodër e më gjere ka me dhjetëra familje të ngjuara. Tani, ne jemi të gjithë të ngjuar dhe nuk kemi frike se na vrasin me pushke. Jemi mërzur e stresuar! Po ata, që kane qëndruar e qëndrojnë me vite të tera brenda katër mureve? Se, dikush paska vra në gjaknxehtësi, apo akoma më keq në gjendje qetësie. Një familje e tere çfarë faji ka, fëmija në djep kujt i ka borxh. Le të jemi një here human, njerëzor e më të dashur me njeri tjetrin, pra edhe të falim. Shembuj ka plote. Po unë po ndalem te shembulli i të ndjerit Dritan Prroni, pastor, i cili e dinte se është në gjak dhe është i rrezikuar nga një vrasje e mundshme. Dhe ka lenë amanet, po qe se kjo ndodhe, gjakun me ja fale. Po, duhet të gjithë të frymëzohemi nga ky akt burrëror, human e mbi të gjitha njerëzor. Populli thotë "trimat të falin!"

Mendoje se, pas kësaj pandemie jeta e shoqërisë do ndryshoje në kahe pozitive. Ta leme njëherë e përgjithmonë urrëjtjen ndaj njeri-tjetrit. Të duam e të respektojmë njeri-tjetrin. Duke ndihmuar shtresat në nevojë, duke përfshire këtu edhe të moshuarit. Të heqim dore nga ato tradita, të cilave ju ka ardhur koha të harrohen. Tani duhet përqendrohemi te plaga më rende, që ne kemi trashëguar, nga gjakmarrja. Me këta që vrasin, të merret drejtësia e re. Se edhe vet gjyqësia shpesh here ka ardhur nge një drejtësi e korruptuar, se vret një apo edhe më shume njerëz dhe pas pak vitesh fiton lirinë! Kjo bën që edhe pala e dëmtuar ndihet jo mirë.

Të gjithë bashke, të përballojmë këto të keqe që na kanë zënë, duke nxjerre edhe mësim, se çfarë të bën një force tinëzë si covid 19. Ne, të luftojmë ata covid, që ja shkaktojmë njeri-tjetrit, shoqërisë në tërësi. Ketë e kemi ne, si shoqëri në dore, duke ndërruar terësishte sjelljet, komu-nikimet me njeri tjetrin. Të bashkuar të gjithë, nuk ka pandemi që nuk ia dalim.

Përgatiti, Ndue Ziçi

EVROPË - Mësime kineze për ekonominë globale

Nga Alfred PAPUÇIU,
5 prill 2020

Kinë, Klientë të kthyer

Ndërsa Europa dhe Shtetet e Bashkuara janë kryesisht në kontroll, Kina tashmë ka filluar rimëkëmbjen e saj ekonomike. Cfarë mësimesh mund të nxjerrin vendet perëndimore nga kjo? A do të dalin nga kriza më e fortë apo më e varur nga Kina?

Ekonomia kineze është rikthyer, por efektet e kontrollit do të vazhdojnë të ndjehen. Si këtu në Ëuhan, epiqendra e epidemisë Covid-19, ku dyqanet mbrohen nga barrierat.

Pas disa javë izolimi në Europë, sytë janë më shumë se kurrë për Kinën. Aq sa të vëzhgoni evolucionin e epidemisë sa të përpiqeni të kuptoni dinamikën ekonomike të një vendi që del nga kriza. E ardhmja e ekonomive perëndimore mund të jetë në bërjen në Kinë, epiqendrën e epidemisë, ku masat e kontrollit gradualisht po hiqen dhe aparatet prodhuese janë rifilluar. Cfarë mësimesh mund të mësojmë për Europën dhe Shtetet e Bashkuara? Cfarë vendi do të ketë Kina në ekonominë globale pas Covid-19?

Rritja ka filluar përsëri në Kinë. Jo me një ritëm të pathyeshëm, por aktiviteti duhet të ishte kthyer në zgjerim, sipas sondazhit të fundit të menaxherëve të blerjeve, të botuar të mërkurën, i cili tregoi një vlerë prej 50.1. Ose pak më shumë se shenja 50, e cila ndan tkurrjen dhe rritjen. Kjo do të thotë që ekonomia kineze u stabilizua në fund të tremujorit të parë dhe se rritja duhet të kthehet në të dytin, sipas një studimi të Julius Baer, të botuar të Premten.

Përveç shifrave zyrtare, Dan Scott vëzhgon edhe të dhëna alternative, siç janë “ndotja ose transporti, të cilat janë në rritje”, tha nënkryetari i ekonomistit të Vontobel. “Shkalla e shfrytëzimit të kapaciteteve është aktualisht midis 65% dhe 70%, që nuk është larg nga 80% e regjistruar në kohë normale, sinonim me kapacitet të plotë”, vazhdon ekonomisti. Ai pret rritje prej 2% këtë vit në Kinë, ndërsa konsensusi pret 5.3%. PBB-ja e Kinës u rrit me 6.8% në 2017 dhe 6.6% në 2018.

Vala e dytë

Nëse parashikimet e specialistëve ndryshojnë sa më shumë, është se mbetet “shumë e vështirë të parashikohet se cila do të jetë rritja e PBB-së kineze për dy tremujorët e parë”, vuri në dukje David Chao, strateg në Invesco, gjatë një mbledhje të organizuar të enjten. Pasiguria mbetet e lartë për ritmin e rimëkëmbjes ekonomike të Kinës, pasi mund të përballlet me një valë të dytë.

Ose më saktë dy valë të dyta: ajo e mungesës së kërkesës nga vendet perëndimore, e mbyllur kryesisht; dhe “ajo e infeksioneve të reja në Kinë të shkaktuara nga të huajt ose kinezët që kthehen nga jashtë. Ose te bartësit e shëndetshëm të virusit, të cilët nuk kanë simptoma dhe tani

përfshihen në statistikat kineze. Kështu që do të duhet të ketë një përgjigje të koordinuar globalisht, “tha David Chao.

Për këtë specialist të Azisë Paqësorit, kriza Covid-19 solli tre ndryshime strukturore në Kinë: “Popullsia beson më shumë në sistemin politik, i cili ka treguar



se mund të reagojë në mënyrë agresive dhe efektive; përparimi teknologjik është përshpejtuar nga investimet publike në 5G ose inteligjenca artificiale; Më në fund, ekonomia ka evoluar në një model në internet, veçanërisht për konsum”.

Klientë të kthyer

Përkundër kësaj, pjesa fizike e aktit të blerjes mbetet shumë e gjallë. Kjo është thelbësore për një numër markash (veçanërisht markat luksoze) që bëjnë pjesë të konsiderueshme të shitjeve të tyre në Azi. Bosi i Sëatch Group, Nick Hayek ishte një nga të parët, më 19 Mars, për të thënë se pa një fillim për rikuperimin në Kinë.

Një mendim i ndarë nga shefat e markave të tjera të globalizuara - bërja e orës apo jo - i pranishëm atje. Më 24 mars, ajo e Nike vuri në dukje për shembull se “trafik i ishte kthyer” në Kinë, por edhe në Japoni dhe Korenë e Jugut. “Konsumatorët janë rikthyer në dyqane. Ata kanë veshur maska, por janë kthyer, “tha ai në konferencën vjetore të rezultateve të grupit.

E pranishme në Kinë me rreth tridhjetë dyqane, marka luksoze Bulgari po sheh gjithashtu një “shërim mjaft të shpejtë”. Bosi i markës së grupit LVMH, Jean-Christophe Babin, vlerëson se niveli i shitjeve të tij “ka qenë atje për tre javë niveli i vitit të kaluar”. Ai zbulon se më pak klientë shkojnë në qendrat tregtare “por që ata që shkojnë atje me të vërtetë duan të blejnë”.

Jean-Christophe Babin nuk po pretendon ende fitoren. Dy pyetje kryesore lindin: “A do të rimarrin vendet e tjera aq shpejt sa ky treg kyç dhe a do të kenë klientët e tyre etjen e njëjtë për konsum?” Ne nuk jemi në gjendje t’i përgjigjemi këtyre pyetjeve në këtë kohë.

Në industri, Schindler thotë se fabrikat e tij kineze janë përsëri në lëvizje të plotë. “Kina është tregu i parë që kthehet dhe po lulëzon,” tha shefi i grupit të ashensorëve Lucern, Thomas Oetterli, të Premten në NZZ. Kina zë 15% të shitjeve të Schindler, ose 1.55 miliardë franga në

shitje në vitin 2019.

Rimëkëmbja në Ë?

Në një periudhë afatmesme, një ringjallje e epidemisë në nëntor mund të shkaktojë një shërim në formë Ë. 7% e PBB-së botërore kundër 19% aktualisht, ende vëzhgon David Chao. Kjo është më e varur nga tregtia ndërkombëtare.

Kontrolli i vendosur në Europë dhe Shtetet e Bashkuara peshon ekonominë kineze, thekson Mathilde Lemoine, kryekonomiste e grupit Edmond de Rothschild, pasi këto dy rajone përfaqësojnë 35.7% të eksporteve kineze dhe 32.8% të eksporteve vendet në zhvillim të Azisë.

Tashmë para shfaqjes së Covid-19, parashikimet e rritjes kineze ishin ulur nga 6.5% në 6%. Dhe duhet të dalë edhe më e ulët se sa pritej, vazhdon Mathilde Lemoine: “Aktiviteti po rifillon në Kinë por do të mbetet në një nivel më të ulët se ai i një viti më parë; për shembull, ne shohim që konsumi i qymyrit është ulur 15% gjatë kësaj periudhe dhe se kapacitetet prodhuese nuk përdoren plotësisht.”

Për Julius Baer, kompanitë kineze do të preken nga masat e kontrollit për shumë lagje. Banka me qendër në Zyrih pret falimentime, rënie të flukseve të parave dhe ndryshime në zakonet në transport dhe shërbime në planin afatmesëm. Midis rënies së investimeve të biznesit dhe kujdesit të konsumatorëve, fitimet e kompanive kineze nuk duhet të rikuperohen para gjysmës së dytë të 2021, sipas Julius Baer.

“Efikasiteti nuk shihet në Perëndim”

Në këto kushte, a duhet që Pekini të nisë programe të mbështetjes ekonomike të ngjashme me ato të vendosura në Shtetet e Bashkuara ose Europë, ku mund

të arrijnë në 10% të PBB-së? David Chao nga Invesco nuk e beson: “Qeveria qendrore nuk dëshiron të rrisë borxhin dhe, vitet e fundit, tendenca ka qenë më tepër të shtyjë drejt një ulje të borxhit të aktorëve ekonomikë, në veçanti nga frika e një flluskë të pasurive të patundshme “. Nga ana tjetër, Pekini ka ngritur rreth tridhjetë iniciativa mbështetëse, të synuara për sektorët ekonomikë (NVM, dixhitale) dhe duhet të vazhdojë përgjatë kësaj rruge, tha David Chao.

Më në fund, a do të dalë Kina forcuar nga kriza e koronavirusit? David Chao peshon të mirat dhe të këqijat. “Nga njëra anë, vendi mund të humbasë rolin e tij si qendër dominuese prodhuese, pasi virusi ka shkaktuar një shkurtim të zinxhirëve të furnizimit. Aktivitetet po kthehen në vendet e zhvilluara dhe bota po bëhet gjithnjë e më e izoluar. Mungesa e tifozëve tregon se varësia e disa vendeve nga të tjerët është shumë e fortë.”

Por nga ana tjetër, Kina gjithashtu mund të “dalë si furnizuesi i vetëm i një grupi të tërë produktesh, sepse ekonomia e saj tashmë ka dalë nga kriza, ndërsa Perëndimi është akoma në gjendje të ndaluar. Në një afat më të gjatë, kompanitë e planetit do të duhet të ulin kostot e tyre, një pikë në të cilën Kina është thelbësore, “argumenton David Chao. Kush duket se favorizon një Kinë më të fortë pas krizës: “Vendi ka demonstruar aftësinë e tij për të përmirësuar epideminë dhe të tërhiqet. Ne nuk kemi parë këtë lloj efektiviteti në vendet e zhvilluara “.

Rimëkëmbja nën kufizime në Azi

Situata në Kinë do të peshojë në tërë Azinë, beson Mathilde Lemoine, e de Rothschild: “Rimëkëmbja aziatike është gjithashtu nën pengesa, sepse Kina importon më pak mallra të ndërmjetme nga pjesa tjetër e Azisë, por ky sektor përfaqëson 15% të PBB-së së Malajzisë, 13% të asaj të Vietnamit ose 8% të asaj të Singaporit.”

Ndërvarësia brenda rajonit ilustron edhe nga turizmi, i cili nuk u kthye në nivelet e tij para krizës, pavarësisht një rikuperimi, sipas Mathilde Lemoine. Kufijtë janë të mbyllur, ndërsa për Tajlandën turizmi përbën 14% të PBB-së, 6% të atij të Malajzisë ose Singaporit, dhe madje deri në 25% në Filipine. “Sektori mund të largohet pak në Azinë Juglindore, ku turistët kinezë përfaqësojnë 20% të totalit, veçanërisht pasi ata nuk kanë qasje në Europë. Por jo para rënies”.

Më në fund, çmimet e dobëta të naftës po mbështesin rritjen në vendet aziatike, duke kontribuar 0.5 pikë përqindje në PBB në Indi dhe Kinë, deri në 2 pikë në Singapor. Për Malajzinë dhe Indonezinë, dy eksportuesit e vetëm të naftës së papërpunuar në Azi, efektet pozitive në faturën e naftës kompensojnë efektet negative.

Në këtë kontekst të përgjithshëm “të shprehur nga një pasiguri e lartë dhe mungesë e perspektivës, investitorët priren të favorizojnë aktivet cilësore, gjë që i shtyn ato më shumë drejt Shteteve të Bashkuara se Kina”, përfundon Mathilde Lemoine./Sébastien Ruche, gazeta zvicerane « Koha », « Le Temps »

COVID-19 U BË REALITET KUDO NË BOTË, - PRA U SHPALL PANDEMIA

Corono-virusi i ri, që shkaktoi infeksionin e quajtur COVID-19, filloi në Vuhan të Kinës, duke u përhapur në gjithë territorin dhe pastaj u përhap fillimisht me 3 rastet e para në France- më vonë në Itali, po përfshin gjithë globin, pra u plotësua Pandemia. Deri tani kemi mbi 1 milion të infektuar, me miliona të karantinuar kontakte të afërta, qindra-mijë të vdekur në botë. -po vazhdon prej muajsh pavarësisht masave drastike e drakonianë të distancimit social e fizik, për të penguar përhapjen dhe për të shpëtuar personat më të ndjeshëm për tu prekur. Kudo jemi të rrahur me mesazhe audiovizive, me propagandë mbrojtës kundër këtij corona-virusi, që po bën kërdrinë siç beri Murtaja në shekullit XIV-XV- deri në fillim të shekullit XIX. Pra Covid-19- është sot preokupimi mbar botëror.

Në këtë nivel të zhvillimit të sëmundjes simptomat po kuptohen më mirë. Sipas Prof. Robert Glater spitali Lenox H ill-Neë-York-tek personat e prekur nga Covid-19 mund të ketë shfaqje të lehte, të mesme ose mortale (vdekjeprurës). Më e keqja është se në pamje të jashtmen simptomat nuk janë specifike, gjë që nënkupton se mund të ngatërrohen (konfondohen) me sëmundje të tjera të aparatit të frymëmarrjes, të rrufës, të gripit sezonal e të tjera. Shenjat më të përgjithshme janë ethe e larte, kolle, teshtitje, vështirësi në frymëmarrje, çrregullimi të tretjes (diarre) me rralle. Ethja është simptoma më i shënuar-sipas raportit të CDC nga personave covid-19 dhe ka veçori që është mbi 38 grade Cel-

cius (101,4 grade Kelëin) dhe shpesh here me të dridhura. Sipas të dhënave ka dhe raste që temperatura të mos jete shenja e pare. Kështu. në Kine 44% e 1000 pacienteve ishte ethja, që i solli në spital dhe sipas një studimi të "Neë England Journal of Medi-cine", në 89% e rasteve temperatura është rritur pas shtrimit në spital. -Kujdes, të mos nënvlerësohen disa shenja, si: kollja, e cila është e shpeshte që takohet 4%, 6-83 e të shtruarve, është fjala për kolle të thatë dhe për këtë duhet distancimi fizik rreth 2 metra larg të personit nga personi, nga që me kollë, teshtitje nxirren në ambient grumbull virusesh që kalojnë tek i shën-doshtë. Prandaj duhet kujdes të kollitëni në një shami letre dhe të hidhet në kosh ose në teshtitje të vendoset këndi i bërrylit para hundëve. Vështirësia në frymëmarrje (dyspnoe), është një shenje me preokupacion për 3-31% të të shtruarve në spital. Sipas Agjencisë antimikrobiale Ndërkombëtare (IYAA), ky është simptoma i trete i rëndësishëm ne 34,5% të të shtruarve-duhet thek-suar se dyspnoe ne një numër rastesh mund te jete nga ankthi dhe mund të rendoj pacientet me Covid-19, po ashtu disponua mund të instalohet pa pritur dhe tek pacientet tashme të shtruar. Sëmundjet e aparatit të frymëmarrjes si pneumonia e rende është specifike e këtij virusi dhe me qene se virusi inondon me lëngje dhe alveolat rezervë duke i bllokuar ka nevojë për O2-TERAPI jo me maske, por me intubim (ventilim mekanik). Shpesh kemi dhe një mbi-infeksion bakterial sipas OMS-it deri 38.1% të të shtruarve-Dhimbja muskulare-që sipas OMS-it takohet në 13,9% të të sëmurave-ku sipas klinikes Cheve-land është simptoma i prekjes së përgjithshme nga infeksioni viral-sipas Glater se në Covid-19 është më brutal (i bezdisshëm) se në gripin sezonal. MOS shkoni në spital ose tek mjeku personal pa prenotim paraprak. -Kështu keni në dispozicion Nr.127 ose me telefon

mjekun personal, -ku merrni udhëzimet ose iu tërheq në qendrën kombëtare në Tiranë.

-Dhimbje koke-në covid-19 takohet e veçuar ose në kombinim me shenja të tjera si dhimbje gryke e të tjera, por është me e rrallë, por kjo dhimbje koke mund ta ketë burimin dhe nga stresi apo ankthi-por duhet të kihet kujdes të merret një interviste e vëmendshme dhe po të ketë dhe shenja si ethe, kolle, dyspnoe dhe ka pasur kontakte jashtë vendit-pra në zona me covid-19-therrisni-127. ' dhe bëni përpjekje për ta ulur me Daphalgan (Daleron) 1gr, ose Ibuprophen (no-rofen) 400-800mg. -Diarrea (heqje barku), -sipas OMS-it takohet ne 3,7% të rasteve, - kështu- rasti i pare me corona virus-Covid-19 në SHBA ishte një burrë 35 vjeç, që kishte ardhur nga Vuhan-Kine, pati vetëm diarre pak kohe para shtrimit, ku kampionet e feçkës dolën pozitiv për covid-19 dhe me pare SYN-DROMI -MERS-Cov, ka pasur shenja gastro-intestinale. Po ashtu sipas kullimi të dhënave (rrjedhje) hundesh është takuar në 4% të të sëmurave që iu është marr kampioni.

Qendra e shëndetit për fëmijët në Stanford rekomandon që fëmijët që kane rrjedhje hundesh me ethe dhe kolle duhet të testohen për grip, ndërkohe që potë ketë ethe mbi 38 grade celsius, kolle dhe vështirësi në frymëmarrje duket se janë kandidat për Covi-19.

-MUNGESA E SIMPTOMAVE- Një raport i OMS për rastet asimtomatik (pa shenja) te Covid-19 këta e kane marr në forme të lehte infeksionin, për arsye të imunitetit ti mire natyral të tyre ose kush ka bërë vaksinimin kundër TUBERKULOZIT (TBC), por ky kontingjent rrezikon të trans-metoje sëmundjen, nga që lëvizin dhe këto raste depistohen vetëm me test specifik, sidoqoftë specialistet theksojnë se po të zbatohet distancimi fizik-social nuk përhapet. Trajtimi-nuk ka deri tani ndonjë trajtim specifik për Covid-19-disa studios po pro-

vojnë disa ilaçe ekzistues. Sipas Re-vistës "Natura" janë testuar deri ilaçe kundër SIDA-Ritornavir ose ASC-09 e të përdorura për mjekimin e EBOLA. Po ashtu pacientet po marrin kujdes mbështetës, me lëngje, analgezike, an-tipyretic-daphalgan (Paracetamol-acetaminofen / ne doza të mëdha 1.0 gr. dhe IBUPROFEN (MOTRIN, ADVIL, NOROFEN) në doza të mëdha, po ashtu dhe REZOCHIN-PLAQUENYL- (ANTIMALARIK) dhe sipas nevojës O2-terapia me maske ose në rastet kritike me intubim (ventilim mekanik) dhe po ashtu izolimi dhe në shtëpi për rastet e lehta-abortive-duke bere teste periodike. Por në Covid-19-po del në pah, -thënia "Është më lehte të parandalosh sesa të mjekosh". Pra, derisa të krijohet vaksina osemedikament specifik nuk mund të trajtojmë me sukses dhe do shterojmë -firojnë aftësitë e sistemit tone shëndetësorë. Përveç humbjeve të jetëve njerëzore, por shpresa ka -në France me 7 Prill 2020 në 60 të sëmur vullnetar filloi aplikimi ilaçit me anticoorpe "Covid-plazma), e marr nga të sëmuret e shëruar-të gjithë të sëmuret po ndiqen me shtrim në spital-pra po behën përpjekje për rikupëruar antikorpet. Por deri tani dhe në vijim suksesi i luftës kundër covid-19 varet nga shpejtësia dhe intensiteti i masave dhe nga solidariteti i masës njerëzve me to-disiplinim-higjenik-kufizim lëvizjesh dhe distanca socio-fizik, që min-imizohen rastet e renda dhe të zbutet sa më shumë kurbat e epidemish. Por dhe sot ka akoma shumë gjera jo të qarta deri në fund.

PRANDAJ DUHET TË JEMI TË DISIPLINUAR DHE TË ZBATOJMË ME RIGORIZITET UDHËZIMET E AUTORITETEVE SHTETËRORE DHE MJEKË-SORE.

*Përgatiti nga Dr. Med. Ndue NIKAJ,
Bushat-SHKODËR, me 10 prill 2020*

MOLLA

Tregim i jetuar

Kur linda unë, në një ditë shkurti, babai kishte menduar të mbillte një pemë molle.

U rritëm bashkë si dy binjakë. Kur mora pak mend më thanë, se molla asht e jotja, ka emrin tënd. Sa herë i shkoja në anë e më dukej sikur rritej nga gëzimi. Një vit bëri lule e mandej dy apo tre kokrra. Asnjëherë nuk urinova te trangu i saj, me duket se po lagu pantallonat e mia. Unë 10 vjeç, ende fëmijë, por edhe pema, motra ime binjake po aq vjeç ishte, por me degë e trung që dukej sikur ishte 50 vjeç. Ajo u mbush me lule, pastaj me ca kokrra të vogla e mandej pak më të mëdhaja, sa unë ia ndukja nga degët për t'i provuar shijen. Vitin tjetër u mbush sa nuk thuhet me kokrra të kuqe e krejt të bukura, gjynah nuk kishim foto.

Një mjes herët dëgjova ulërimë qensh që ziheshin në oborr. Ashtu edhe i pa veshur dola me vrap. Ishte qeni i Rasimit, komshiut tim, që kishte zënë përfyt Xhixhin, qenin tonë të shtëpisë. Unë i shihje tek rrokulliseshin nëpër oborr e ziheshin për vdekje o ngordhje. Dreji e merr vesh ku u kishte mbet hatri me njëritjetrin. Më hyni inati. Mora një shkop dhe fillova të qëlloj qenin e komshiut. Xhixhi u bë m' zemër e filloi sikur të krenohej dhe të merrte forca. U ndan së fundi. Duke hungëruar qeni komshiut iku te gardhi vet, ku ishte një vrime e u hodh tej.

Rasimi, i zoti qenit, kishte parë gjithë ske-

nën. Ai ishte nja 9 vjet më i madh nga unë. Nuk foli asnjë fjale, por kontrollloi qenin e vet për ndonjë plagë dhe iku për në shtëpi të vet. Unë mbeta për pak aty në oborr, ku nën shikimet mirënjohëse të Xhixhit, gati me vinte për të qarë.

Zhurma kishte hyrë deri te dhoma ku flinin prindit, të cilët dolën, por pasi kishte mbaruar ndeshje. U shpjegova me dy fjalë për t'i qetësuar. Dita vazhdoi krejt normal, sikur asgjë nuk kishte ndodhur, veç shikimet e ndonjë zë, që lëshonte qeni në shenjë mirënjohje brenda praktik të shtëpisë ngujuar brenda, për t'iu shmangur ndonjë tjetër luftë me qenin e botës.

Vjeshta kishte sjelle mjaft prodhime, edhe molla ime ishte plot me kokrra të kuqe, sa babai më thoshte se duhet të presim edhe një javë e do ta vjelim me ceremoni me shporta degë për degë e kokërr për kokërr që t'i ruajmë për dimër. Numëroja ditët se kur Vjenë ajo e bekueme ore që te vjelim mollën time vjeshtake.

Përsëri u zgjova herët në një ditë shtatori të kthjellët, të bukur e plot dritë e ajër. U ktheva të shikoj mollën, për të pare kuqaloshet të shndrisin nen rrezet e diellit parë. Fërkova fort sytë, se mos isha andërr. Të gjitha kokrrat bashkë me degë ishin shtruar përtoke. Një kokërr teper e plagosur ishte rrokullisur deri te kambët e mija të zbatuara. Më erdhi të ulërija, por pastaj me lot që më rrokulliseshin faqeve vrapova brenda dhe i thirra babës. Dolën prindërit si në një alarm. Zëri im i çjerrë i kishte trishtuar me shumë nga ajo që do të shihnin. Kur pa mollën që dukej sikur kërkonte ndihmë, motra e madhe zuri të qajë edhe ajo me za. Babai nuk foli, ndërsa nana tha " na marrtë të keqën", por

askush nuk e zuri ne gojë dëmtuesin. Një dorë gjakatare kishte ardhur natën dhe pa mëshirë e me një shkop të gjatë në dorë kishte shemb përtoke degë e kokrra bashkë. U kuptua. Ishte komshiui, Rasimi.

Ra heshtje. Babai bëri me shenj të hynim brenda dhe ashtu bëmë. Ditë me radhë mendoja si të hakmerresha. Mendoja armën e vrasjes, herë në andërr e herë zgjuar. Lloj, lloj planesh më vinin në kokë. Një natë mendova t'i djeg shtëpinë Rasimit, por kisha frikë errësirën të lëvizja natën dhe qenin që me urrente për vdekje. Ishte gja e pamundur, - thashë me vete. Një armiqësi në heshtje rrokulleu fqinjën tone, ku kishim shkëmbyer një jetë korën e bukës, një filxhan kafe apo edhe një ene për çfarë njeriu ka nevojë. Babai i mblodhi një për një kokrrat gati të pjekura dhe i futi në një gaxh prej drumi shumë të madh, ku i la të fermentohen dhe pas dy jave vuri kazanin. Një raki që kurrë nuk ishte pa e as dëgjuar në anët tona. I thashë babës planin tim për hakmarrje. Ai qeshi, me një të qeshmë që e kishte karakteristike, kur deshtë të tallej me ndonjë. Pastaj serioz me tha: "Kurrë, kurrë, as mos të shkojë në mendje. Fqinjët janë si vllazën. Ai aq mendoj, aq bani. Ne do të bajmë tonën". Unë nuk e kuptova ketë "do të bajmë tonën", ndoshta, - thashë me vete do të hakmerrej ai vetë. Askush në fshat nuk e mori vesh ç 'kish ndodhur, veç gjithë fshati u çudit me rakinë e mollës, e cila praktikohet për herë të parë në viset tona. Nuk mbet njeri pa ardhur për të provuar rakinë eksperimentale.

I vrare në shpirt, Rasimi mbajti distance për ca muaj e unë mendova se cila do të ishte hakmarrja e babës dhe kur, por kurrë nuk më shkoj ndërmend se e vetmja hakmarrje ishte

ajo e bekuar raki që curronte në një enë plot.

- Një ditë dëgjua një zë në derë, - "O i zoti i shpisë!"

- "Urdhno e mire se te pruri Zoti!", - iu përgjigj baba.

Ishte Rasimi. Në një moment u drodha. Atëherë do të hakmerrej ai mendova. Kur hyri brenda pashë se mbante një lepur të egër kapur për veshësh me njëren dorë. Në kurthet e shumta të dimrit që vendoste Rasimi kopshtijëve me lakra, kishte mund të zinte lepurin, të cilin na e solli gjallë, sa kurrë nuk kisha parë as takuar një kafshë të egër, aq më tepër një lepur. Harrova qentë, harrova mollën dhe i sillesha plot dëshirë e frikë kafshës së gjorë, e cila përpëlitej në dorën tashmë të fuqishme të Rasimit, i cili po na e falte neve.

Ai bashke me babën, me gota para e një meze, që përgatit nana, shijonin rakinë e mollës time, të vjel "pa pagesë" nga komshiui, duke treguar historinë e lepurit, kurtheve dhe borës që kishte mbuluar tokën.

Në këtë kohë virusi e mora në telefon për të pyetur për shëndetin e Rasimit. Iu duk sikur i fala gjithë boten, kur dëgjoi zërin dhe emrin tim. Rasimi sot 82 vjeçar fliste me ndërprerje, ndoshta nga emocioni, o ndoshta edhe me një pikë loti mbi faqe prej mallit e largësisë, ku na ndau jeta. Nëpër bisedën tonë kaluam në kujtesë emër për emër gjithë atë brez, që sot nuk është më. Tash ma edhe ne të dy dalëngadalë po bëjmë dorëzimet e fundit bashkë me mollën e zgavruar duke i lenë radhën breznive që do të vinë.

**Ndoc SELIMI,
mars 2020**

PSE FSHIHET E KALUARA ARKEOLOGJIKE E TIRANËS?

Pse ky mos interesim që nga paslufta e dytë botërore e deri sot? Janë bërë gërmime brenda mundësive deri në skajet e më të largëta të Shqipërisë, ndërsa Tirana dhe nëntoka e saj e mbushur plot dëshmitare të një kohe të lavdishme, të luftërave, të kulturës dhe të disfatave nuk evidentohen dhe nuk behën gërmime për të mësuar atë që fshihet këtu nëntokë. E vendosur në një pellg deti prehistorik, rajoni i Tiranës ruan në gjirin e vet dëshmi të padiskutueshme të një të kaluarë të largët e të lavdishme deri në ditët të sotme.

Zbulimet arkeologjike me interes dhe me një bujë në mediat, janë gjetur krejt rastësisht gjatë gërmimeve për themele etj. Të tilla janë p.sh. Mozaiku në Bazilikën në rrugën Naim Frashëri zbuluar gjatë themeleve të një bllok pallatesh me 1972. Të Krojet e Shëngjergjit gjenden fragmente muresh dhe asnjë interes, veç një ideje që ishte një kishë e vjetër e mjaft. Tani mbuluar ma pallate. Konsulli francez Aleksandër Degrand me 1901 na bën të ditur se ndodhet pranë Lumit të Tiranës një nekropol romak dhe thotë se “kjo gjetje të çon të lufta në mes Cezarit e Pompeut”, por ne 100 vitet e fundit asnjë interes!!

Austriaku Karl Patsch me 29 maj 1923 gjen themelet e një ndërtese në Laknas, po në Tiranë, si dhe një thikë, enë balte, si dhe një gjilpërë ari në lagjen Brutka.(2). Përgjatë lumit të Tiranës i quajtur Argjilata, Refik Toptani gjen një dysheme me tulla ku dilte edhe një burim i quajtur nga vendasit “Vendi i mirë” si vazhdim i një qyteti të nëndheshëm deri në Valias, ku përsëri Patsch thotë se banonte një popullsi e shpeshtë. (Asnjë interes organet kompetentë, tashmë të mbuluara me pallate. !!). Për të vazhduar me tej te Skulpturat antike të Baldushkut, Statuja e Hermesit në Berzhit gjetur gjatë hapjes së rrugës, pllakat dhe varret prej guri ne Paskuqan, monedhat e argjentit pranë Pallatit të ri Mbretëror me 1963 në Sauk gjate hapjes se themeleve të një ndërtese. U gjenden rreth 63 copë monedha, 7 nga të cilat prerë në punishtet e Apolonisë. Monedhat me të reja mbanin emrat e konsujve romakë si L. Konelius Lentulus dhe C. Claudios Marcellus. Të gjitha këto i takojnë vitit 49 para Krishtit, kur i bie që Pompeu i lëshon Romën Cezarit e hidhet në anët tona bashkë me konsujt që u përmendet emri në monedhat. (Sipas K. Frashëri, Historia e Tiranës” fq 31). Po ashtu thesari i Vrapit me një mori veglash e kupën prej ari që sot gjenden ne Paris e Amerikë e të tjera e të tjera, ku deri tani nuk është thënë fjala e specialistit dhe nuk janë vënë në planin e kërkimeve (të paktën deri sot 2020).

Po kishat e rrënuara në zonën e Tiranës?

Asnjë fjalë, asnjë shkrim, asnjë kërkim me specialistë. Popullsia e Tiranës konvertohet ne myslimanizëm rreth viteve 1610 - 1634 për të arritur deri te vitet 1650,

90% e konvertuar, këto sipas relacioneve kishtarë te këtyre viteve. Kur Konsulli J. G. von Hahn viziton Shqipërinë për here të dyte me 1863 shkruan: “... se në vi-



Kisha e Shën Mërisë



Mozaikë dyshemeje kishë



Mure të këshjtjellës së Dajtit

set ku buron Erzeni ndodhen shume kisha të krishtera, të rrënuara” (3)

Dom M. Dushi i përmend me emra ish kishat tashme te rrënuara në trevën e Tiranës: Kishën e Shën Gjinit te krojet e Shën Gjinit, Kishën e Shën Mërisë në Brar, Kishën e Shën Kollit ne kodrat e Selitës, Kishën e Shën Kollit ne Prisen e Vogël, Kishën e Shën Kollit në Qafë Mollë, Kishën e Shën Gjergjit në Tujan, Kishën e Shën Pjetrit në Shën Pjeter” (quhej vendi ku është sot Sanatoriumi). Ki-

sha e Mukajt e kthyer në xhami, si dhe një tjetër numër kishash na përcjell Cordignano si ajo e Shën Barbara në Bastar, Shën Mikelin në Mner, e Shën Gjinit në Damjan e të tjera. 4,5)

Arkeologu Skënder Muçaj thotë, se Tirana ka qene qendra e krishterimit në Shqipëri. Nga vëzhgime krejt të përcipta në zonën e Piskës deri në Percellesh janë gjetur shtate kisha, ku njëra ka një sipërfaqe prej 2000 m², që mund të ketë qene një qendër peshkopale. Po ashtu vetëm në fshatin Derje jane gjurmuar shtate kisha e kapelone deri tani. Numri më i madh i kishave janë gjendur rreze Dajtit, por edhe në Vore, ku është zbuluar një faltore dhe një këshjtjelle. Kjo tregon për një popullsi të dendur dhe banoret ishin të besimit katolike. (6)

Fati i këtyre kishave ka qene vete një trishtim. Me okupacionin turk shumica u shemben, një pjese u kthyen në xhami dhe të tjerave u ka humb nishani. Po interesimi i më pastajmë? Komunizmi!! Post komunizmi!. Harresa është e tmerrshme. Harresa është vdekje e mbuluar përgjithmonë me hi. Asnjë shkrim, asnjë foto, asnjë vend turizmi ndër këto qindra troje. Shumë intelektualë dhe udhëheqës të Tiranës tash 100 vjet, mendojnë dhe i atribuojnë fillesat e Tiranës vetëm më 1614, në kohën kur u duk pas-hai Sulejman Bargjini. Informacioni i gjithë këtyre objekteve me vlera botërore ekziston, por është vetë mungesa e interesimit të guaditatorve (udhëheqësve) dhe më shumë, mendoj unë, frika nga e kaluara. Ajo që ka ndodhë, është fakt dhe nuk mund të ç behët. Pra pushtimi dhe konvertimin është fakt, por në emër të këtij konvertimi nuk mund të fshihet e kaluara po aq e ndritshme sa ditët tona. Shumica e këtyre vlerave arkeologjike janë gjetur nga ekspolor të shekullit XIX e XX, por edhe rastësisht.

U lumtë njerëzve që punojnë me shpirt e zemër, në mënyre të pavarur e me shpenzimet e tyre për të nxjerre në drite diçka, për popullin e tyre, për Shqipërinë, për të ardhmen e brezave. Sa më e vjetër historia, aq më e madhe kushineta e një populli.

Literatura:

- 1- (Degrand “Suvenirs de la Haute - Albanie “ Paris, 1901 fq 196).
- 2- (Patsch “Gjendja ekonomikë e kulturore e Shqipërisë”, Tiranë 1925 fq. 59).
- 3- (Hahn “Udhëtime nëpër viset e Drinit e Vardarit” fq 29. .
- 4- (D.M. Dushi “Tirana dhe rrethinat e saj” fq 143,158, 159,
- 5- Cordignano : “Geografia ecclesiastica dell’ Albania...”1934, fq. 159.
- 6 - (Gazmend A. Baku “Tirana e vjetër” fq. 37).

Përgatiti: Ndoc SELIMI

“TAKOJ EMOCIONET”

Emocionet janë themelore, sepse i japin gjallëri, ditë pas dite, jetës sonë. Ato mund ta kushtëzojnë në mënyrë pozitive apo negative humorin tonë, reagoimet tona me të tjerët, me një fjalë mund të kushtëzojnë lirinë dhe lumturinë tonë. Atëherë, çfarë duhet të bëjmë? Para së gjithash t'i njohim dhe pastaj të mësojmë t'i mbarështojmë ato, pasi nëpërmjet një njohje të saktë të emocioneve dhe të një mbarështimi të vetëdijshëm dhe të pjekur të tyre, mund të jetojmë në harmoni me veten dhe me të tjerët.

“Takoj emocionet” është një rubrikë e cila do të trajtojë pikërisht këto njohje dhe mbarështim të emocioneve njerëzore, me të cilat bëjmë përvojë çdo ditë secili prej nesh.

PJESA E PARË INTELIGJENCA EMOTIVE¹

pesë aftësitë emotive
PËRKUFIZIMI I INTELIGJENCËS
EMOTIVE

Inteligjenca emotive është një formë e inteligjencës që lidhet me aftësinë për të provuar emocione jo racionale dhe për t'i përdorur ato në mënyrë të vetëdijshme.

PESE AFTËSITË EMOTIVE TË INTELIGJENCËS EMOTIVE

1. Vetëdija emotive, që krijon zakonisht:

a. aftësinë për të dalluar momentin e lindjes së një emocioni dhe për t'i dhënë një emër atyre në një situatë të caktuar;

b. njohjen e sinjaleve fiziologjike që shoqërojnë lindjen e një emocioni;

c. aftësinë për të kuptuar shkaqet që çojnë në lindjen e një emocioni të caktuar.

Prania e niveleve të mira të vetëdijes emotive sjell:

-një dialog të mirë me vetveten, që është hapi i parë për të respektuar kërkesat dhe nevojat vetjake, kur bëjmë zgjedhjet tona, të vogla apo të mëdha;

-një mos-shtypje të emocioneve që provojmë, që është hapi i parë për të mbarështuar në mënyrë të efektshme emocionet nëpërmjet një atribrimi me kuptim të asaj që po na ndodh, që arrihet nëpërmjet përdorimit të gjuhës me të cilën përcaktojmë atë që provojmë;

-një aftësi për të njohur në kohë sinjalet fiziologjike që shoqërojnë një emocion, duke arritur në këtë mënyrë që t'u bëjmë ballë gjendjeve emotive më të forta, nëpërmjet përdorimit të teknika të ndryshme parandaluese.

Mungesa e tejskajshme e kësaj aftësie përkon me mohimin e emocioneve vetjake, që mund të përbëjë bazën e prirjes së qëndrueshme për heshtjen emotive, që në psikiatri quhet *alesitimi*=mungesë fjalësh

për të përcaktuar emocione vetjake.

Kjo është një karakteristikë që ndeshet kryesisht:

-tek të sëmurët psikosomatikë dhe tek personat që kanë pësuar trauma të forta, këto krijojnë mekanizma të fortë mbrojtës ndaj realitetit së tyre të brendshëm, që është burim vuajtjeje;

-tek toksikodipendentët, kur veprimi zëvendëson reflektimin mbi vetveten.

2. Kontrolli emotiv që shfaqet kryesisht nëpërmjet:

a. kontrollit të impulseve dhe të emocioneve;

b. kontrollit të agresivitetit drejtuar kah të tjerët;

c. kontrollit të agresivitetit drejtuar kah vetvetja.

Kontrolli emotiv ka të bëjë me aftësinë për të ndryshuar emocionet vetjake nga ana e brendshme dhe e jashtme.

-Kontrolli i brendshëm ka të bëjë me aftësinë për t'i lënë hapësirën e nevojshme emocioneve, si në kohëzgjatje, ashtu edhe në intensitet.

Personat që janë në gjendje ta kontrollojnë siç duhet gjendjen e tyre emotive:

Personat që janë në gjendje të kontrollojnë siç duhet gjendjet e tyre emotive:

-janë më të përshtatur nga ana shoqërore;

-janë më të prirur për të pasur sukses në jetë.

Në këtë sektor të inteligjencës emotive një deficit:

-i lehtë shkakton probleme marrëdhënore, që mund të ndikojnë edhe në jetën shkollore, të punës...

-i rëndë përbën thelbin e shumë patologjive psikiatrike:

*çrregullimi antisocial i personalitetit: prirja për të vepruar pa planifikuar, që përshkruhet si impulsivitet dhe mosaftësi për të bërë plane, ngacmueshmëri (person quhet zemërak, hidhërak) dhe agresivitet me prirje për t'u ndeshur fizikisht;

*çrregullimet e oreksit: bulimia nervore.

*çrregullime të kontrollit të impulseve, që janë patologji që rrjedhin nga paaftësia ekstreme për t'u bërë ballë impulseve, si: lojërat e fatit, piromania (mania për të vënë zjarre) dhe kleptomia (mania për të vjedhur).

dëshiruar.

Paaftësia ekstreme për t'u vetëmotivuar quhet impotencë e mësuar, dhe është qëndrimi që sjell një prirje kronike për ta vlerësuar qysh në fillim si të pakapërcyeshme çdo vështirësi. Një gjë e tillë do të shkaktojë nënshtrim dhe pasivitet përballë mospasurisë, duke i dhënë një goditje vendimtare vetëvlerësimit, që është themeli i mirëqenies psikologjike.

4. Empatia, përfshin:

a. aftësinë për të njohur treguesit emocionalë të të tjerëve;

b. ndjeshmërinë ndaj emocioneve dhe bashkëndarjen e tyre;

c. marrja e perspektivave të të tjerëve.

Personat empatikë:

-janë të aftë të krijojnë marrëdhënie me të tjerët, meqë personi ka prirje të ushqejë sjellje pro shoqërore dhe bashkëpunuese;

-ndjeshmëria ndaj emocioneve dhe ndaj perspektivave të tjetrit konsiderohet një karakteristikë që përcakton asertivitetin apo atë stil komunikimi, që karakterizon një individ shoqëror, të sigurt në vetvete dhe të hapur ndaj ballafaqimit.

Falë empatisë sjellja asertive minimizon rrezikun e keqkuptimit duke nxitur një kontakt, që respekton hapësirën dhe kërkesat e të tjerëve.

Mungesa e empatisë është njëri prej kritereve që dallon çrregullimin narcizistik të personalitetit dhe i bën personat të paaftë për të njohur ndjenjat dhe nevojat e të tjerëve, duke qenë se janë gati vazhdimisht të thithur nga nevojat e tyre.

5. Mbarështimi i efektshëm i marrëdhënieve ndërpersonale, që përcakton:

a. aftësinë për të negociuar konfliktet duke u prirur për të gjetur një zgjidhje;

b. aftësinë për të komunikuar në mënyrë të efektshme me të tjerët.


Përcakton mbarështimin e konflikteve dhe gjetjen e zgjidhjeve; është një dhunti që na bën të aftë t'i heqim gurët që pengojnë një kontakt harmonik me të tjerët dhe që prodhon efekte pozitive në jetën e çiftit dhe të marrëdhënieve miqësore; gjithashtu kur kjo aftësi është mbizotëruese tek një person, e bën atë të efektshëm kur punon me të tjerët. Për këtë arsye kjo aftësi, e quajtur edhe **art social**, është konsideruar dhuntia emotive e lidërave.

Nga prania e kësaj fushe emotive varet edhe aftësia për të komunikuar në mënyrë të efektshme, që është themelore për atë që kujdeset për marrëdhëniet publike.

Personat që e zotërojnë atë kanë aftësi të mëdha negociuese, janë në gjendje të hyjnë në marrëdhënie me të tjerët më me lehtësi dhe janë shumë të aftë për të lexuar dhe për të respektuar ndjenjat e të tjerëve.

Mungesa e këtij fushe emotive mund të shkaktojë vështirësi marrëdhënore, që, në rastet më ekstreme, mund ta çojë personin deri në izolim.

Psikologe Loreta TOMA



-nuk e lënë veten të tronditen nga përvojat e veta afektive;

-nuk lënë që emocione negative (ankthi e trishtimi), të bëhen ndjenja të qëndrueshme;

-i ndajnë emocionet nga veprimet, që është baza e aftësisë për t'u përqëndruar në kryerjen e një pune, për të reflektuar dhe për të planifikuar veprimet.

Një deficit në këtë sektor të inteligjencës emotive mund të shfaqet edhe nëpërmjet prirjes për ta drejtuar agresivitetin shpesh dhe në mënyrë të tepruar brenda vetvetes. Ky qëndrim gjatë atribimeve shkakore të ngjarjeve të jetës mund të përcaktojë një vetëzhvlerësim pak a shumë të theksuar dhe ndeshet shpesh tek personat që vuajnë me depresion.

-Kontrolli i jashtëm ka të bëjë me aftësinë për të shprehur siç duhet emocionet.

1 DANIEL GOLEMAN, *Intelligenza emotiva: che cos'è e perché può renderci felici* (Inteligjenca emotive: çfarë është dhe pse mund të na bëjë të lumtur), BUR, Bergamo 2011.

FAMILJA DHE “FATI”



Leke IMERAJ,
shkrimtar e përkthyes,
në Gjermani

Për t'u martuar, nuk ka asgjë të vështirë. Martohet gjithkush. Gjithkujt i del «fati» i vet, nëse duhet menduar fat. Për të bashkëjetuar, është shumë e vështirë. Këtë nuk e bën dot gjithkush. Jo gjithkujt i ecën «fati».

Shumë veta e mendojnë familjen fat dhe gjithçka e lënë në dorë të «fatit». Zakonisht, të tillë janë ata që, para martesës, i mbyllin të dy sytë dhe pas martesës, nuk shikojnë më «trarin» në syrin e tyre, por «qimen» në syrin e bashkëshortit. Në të vërtetë, a është martesë dhe familja fat apo diçka tjetër!? Le të vazhdojmë më poshtë, duke filluar me një shembull nga bota e kafshëve. Jo rastësisht. Kush njih botën e kafshëve, njih artin e të jetuarit.

Një burrë shkoi në dyqanin e kafshëve dhe bleu një krokodil dhe një akuarium. Krokodili ishte i vogël, por edhe akuariumi, gjithashtu. Shitësi u mundua t'i shpjegonte blerësit se krokodili rritet shumë shpejt dhe se pas një kohe të shkurtër, akuariumi nuk e nxë më. Por, burri as që ia vuri veshin këshillës së shitësit dhe bëri atë që mendoi vetë. Krokodili vazhdonte të rritej ndërsa akuariumi mbetej po ai që ishte. Dikur, krokodili u rrit aq shumë, sa e mbushi plot akuariumin me trupin e tij. Ngaqë nuk mund të ishte ndryshe, ai iu përshtat akuariumit dhe u bë komplet katërkëndësh. Askush nuk mund të thoshte më se ç' lloj kafshe ishte ajo.

Unë nuk mund ta di se në çfarë «akuariumi» e rrit secili familjen e vet, por, nëse dikush mendon ta rrisë si burri më lart krokodilin, ajo mund të marrë çdo formë, por kurrë atë të familjes së vërtetë. Nëse më vonë do të rrimë duke vrarë mendjen se kush e kishte fajin, «krokodili» apo «akuariumi», nuk do të thotë se e kemi gjetur zgjidhjen.

Familje ideale nuk ka, sepse nuk ka bashkëshortë idealë. Nuk ka bashkëshortë idealë, sepse njeriu ideal, mashkull apo femër qoftë (nëse ai ekziston), nuk do ta përsërishte kurrë gabimin fatal të paraardhësve të vet, martesën.

Martesa është një organizëm i gjallë, i cili gjatë gjithë ekzistencës së vet vuan nga tre armiqtë të rrezikshëm: ndjenja e xhelozisë, e frikës dhe e pasigurisë. Pa përrjashtuar pengesat e tjera të pafundme,

të cilat vijimisht mundohen t'ia bllokojnë rrugën dhe t'ia zënë dritën e diellit.

Kur mbaron muaji i njaltit dhe fillojnë detyrat, drita fillon të zbehët dhe hijet të forcohen. Fëmijët, natyrisht që sjellin gëzim në familje, por edhe tronditje të familjes. Pagjumësi, lodhje, grindje, kur janë të vegjël dhe «tërmet», kur futen në moshën e adoleshencës. Gjendja e vështirë financiare, traditat, tabutë, opinioni, pala e burrit, pala e gruas dhe njëmijë e një probleme, shfaqen në «organizmin» familje, i cili me vështirësi mbahet për veten e vet. Dhe shpërthen.

Një gjendje e tillë, të bën të mendosh: a ka më kuptim familja sot!? Dhe nëse po, cili është ky kuptim? Çfarë duhet të zgjedhë njeriu i sotëm, vetminë apo familjen? Ku është ndryshimi midis atyre që ndahen dhe atyre që bashkëjetojnë?

Edhe kur nuk ka përgjigje, njerëzit e gjejnë vetë atë. Dikush mendon: «Martesa është guxim dhe ndershmëri», tjetri: «Vetëm guxim dhe fitore», «dashuria tek ne është akoma e fortë» e të tjera.

Sipas mendimit psikologjik, në periudhën e martesës njeriu kthehet dhe njëherë në fëmijëri. Në mënyrë të vetëdijshme apo të pavetëdijshme, riaktivizohen gjurmët e dhimbjeve të së kaluarës, dhimbjet e mungesës prindërore, injorimi, poshtërimi, keqtrajtimi, si dhe kënaqësitë e përjetuara. Nëse fëmijëria ka qenë e vështirë edhe në martesë njeriu përjeton të njëjtat gjëra. Rreziku i dështimit të martesës është tepër aktual. Nuk ka mashkull as femër që të mund t'ia fshijë partnerit të vet dhimbjet e fëmijërisë, të shkaktuara nga prindërit e vet.

Partnerët gjenden vazhdimisht para dilemës, të bashkohem me tjetrin dhe të përbëjmë kështu një trup të vetëm, apo të qëndrojmë vetëm, i pavarur. Nëse unë i bashkohem «gjysmë hënës» tjetër, sigurisht që hëna do të bëjë më shumë dritë. Më shumë dritë, do të thotë që secili të shikojë më shumë dhe më larg. Kjo është e mirë. Por më shumë dritë do të thotë edhe pamundësi për të fshehur secili të fshehtat e veta para tjetrit. Po sikur ai t'i mësojë të fshehtat e mia!? Shumë çifte lëkunden midis kësaj dileme. Kjo i bën ata të përjetojnë konfliktin e përhershëm të afrimit apo largimit, të bashkimit apo ndarjes, të shkrirjes apo ngrirjes.

Nëse në fillim martesë duhet menduar si diçka romantike, me kalimin e kohës ajo e humbet këtë vlerë. Kthehet thjesht në një «projekt» të përbashkët për të dy bashkëshortët, të cilin e kanë bërë bashkë, përpunuar dhe zbatuar bashkë dhe që do ta gëzojnë bashkë. Nuk ka fare të bëjë me fatin.

Gjithçka që ndërtohet nga njerëzit, kurrë nuk mund të mendohet e pashembësme dhe e pavdekshme. Edhe ky projekt, kështu duhet menduar. Sigurisht që do t'i duhet të përballojë shumë dallgë dhe stuhi, por, nëse të dy «pronarët» janë të ndërgjegjshëm për atë që kanë ndërtuar dhe do të jenë vigjilentë në çdo rast rreziku, ai nuk shembet. Nuk mjafton vetëm fati, për ta mbajtur në këmbë.

Ai që guxon të paketojë valixhen dhe t'ia mbathë, për një të «çarë» të vogël, nuk i duhet besuar kjo. Në fakt, ai e ka menduar me kohë valixhen, por ka pritur «shkakun», të çarën.

Kur rriten fëmijët, shumë gra përjetojnë një lloj metamorfoze. Prirjen nga tendenca e largimit nga ngushtësia e partneritetit. Natyrisht, kur partneriteti është i dhunshëm dhe i padurueshëm. Disa i referohen traditës dhe e durojnë dhunën, kurse disa të tjera paketojnë valixhen dhe largohen. Është e njëjta sjellje, si në fazën e pubertetit. Edhe tani edhe atëherë, ka të bëjë me prirjen për autonomi ndaj detyrimeve dhe dhunës. Meshkujt, në përgjithësi, mundohen ta vendosin ekuilibrin me dhunë, një mënyrë kjo, në të shumtën e rasteve e dështuar.

Në shumë raste, diferenca intelektuale midis partnerëve bëhet shkak për konflikte të përhershme. Ndodh që njëri apo të dy, ia zënë rrugën njëri-tjetrit, për të mos e lënë të parakalohet. Pas 22 vjet martesë, u ndanë bashkëshortja «A» me bashkëshortin «B». Gjatë jetës bashkëshortore, «A» kishte shfaqur talent për pikturë, ndërsa «B» për të shkruar. Asnjë hap më tej. Pas ndarjes, shpërtheu secili në talentin e vet dhe të dy u bënë shumë të njohur.

Meshkujt inferiorë, mundohen që inferioritetin e tyre ta mbulojnë me agresivitet dhe dhunë, mjete këto që, në të shumtën e rasteve, sjellin dështim. Femrat e bëjnë këtë në mënyrë më të rafinuar. Kur e shikojnë se burri bëhet xheloz për aftësitë dhe dritën e saj, tërheq menjëherë «frenat e dorës».

Zina, kur ishte akoma e fejuar, një ditë mori metrin me vete dhe shkoi tek shtëpia e të fejuarit, Tani, «kam ardhur të mat muret e dhomës, për të parë se ku mund ta vendosim bibliotekën», - i tha ajo.

«Çfarë na duhet biblioteka, - unë nuk mbaj libra, nëse ke të tillë, i mbyllim diku në bodrum dhe kaq», - iu përgjigj Tani. Të dy ishin me shkollë të lartë. Edhe sot, pas 15 vjetësh martesë, Tani nuk merret me libra. Thuhet se leximi dëmton injorancën. Me sa duket, Tanit nuk i pëlqen ta rrezikojë injorancën e vet. Zina, megjithëse në punë dhe me tre fëmijë, ka mbaruar edhe një fakultet tjetër dhe vazhdon të mbrojë titullin shkencor. Në të vërtetë, ajo ndihet shumë keq kur, në sytë e burrit, në vend që t'u drejtohet rrobave të pahekurosura, i drejtohet universitetit. Ajo e ka kuptuar me kohë se burri i saj ndihet shumë keq para ngjitjes së saj të pandërprerë drejt dijeve. E ka lënë shumë prapa, aq prapa sa, kur e shikon, i duket si një pikë e vogël, e cila sa vjen dhe zvogëlohet. (Në fakt, ai ka lënë veten). Një ditë, Tani i tha asaj si me shaka, por jo dhe aq: «Zina, sikur më ke parakaluar shumë! Si do të vejë kjo puna jonë?»

Kur Zina fillon të tregojë diçka, ai ndjehet shumë keq. I duket vetja një hiç, para saj. Zina mundohet ta mbrojë dhe tërhiqet ose e thjeshtëson bisedën deri në nivelin e tij. Dituritë e saj i tregon vetëm në sasi të vogla, me qëllim që ai të mos ndihet i fyer. Në rrethin e saj shoqëror, ajo

e tregon nivelin e saj të lartë, por gjithmonë në mungesë të Tanit. «Tërheq frenat e dorës».

Prioritetet e gruas janë burri dhe martesë. Trashëgimi empirike. Prandaj i duhet që gjithë jetën e saj të investojë aq shumë për t'i mbrojtur dhe pasur ato.

Jo pak njerëz mendojnë se martesë funksionon vetëm kur të dy bashkëshortët ngjizen me njëri-tjetrin, si vëllezërit siemeze. Të tjerë mendojnë se baza për një jetëgjatësi martesore është liria dhe hapësira midis partnerëve. Pavarësisht nga bashkimi çiftar, të dy bashkëshortët janë shumë më të ndryshëm, se sa të ngjashëm me njëri-tjetrin. Janë gjini të ndryshme, të lindur në kohë të ndryshme, në familje të ndryshme, në vende të ndryshme, në besime të ndryshme, në...aq të ndryshme, sa të duket sikur nuk kanë asgjë të përbashkët. Nëse një ditë njërit do t'i duhet që për hir të tjetrit, me hir apo me pahir, t'ia mohojë vetvetes të gjitha këto të ndryshme, kush mund ta mendojë se si do të jetë ky njeri!? Është e pamundur ta mendosh. Tjetërsimi i vetvetes është i pamundur. Liria për vetveten dhe partnerin është e domosdoshme. Partnerët, as nuk e rritin dhe as nuk e edukojnë njëri-tjetrin. Gjithçka që ata mund të arrijnë tek njëri-tjetri, është të pranojnë kulturën e njëri-tjetrit, karakterin e njëri-tjetrit, veçoritë individuale të njëri-tjetrit. Çdo provë për ta ndryshuar tjetrin, jashtë dëshirës dhe vullnetit të tij, është e dështuar. Pavarësisht nga mjetet që do të përdoren. Që të prodhojnë fruta, pemët duhet të kenë distancë me njëra-tjetrën. Ndryshe degjenerojnë në pemë pa kokrra.

Pas shtatë vitesh martesë, Roza hoqi dorë nga aktivitetet e përbashkëta me burrin. Interesat e tyre ishin shumë të ndryshme. Roza kërkonte një jetë sa më aktive, për veten e vet dhe dy fëmijët. Burri kërkonte një jetë sa më të «rehatshme», të sigurtë dhe pa telashe. Nuk i bëhej për asgjë. Në familje është rikthyer paqja. Të dyja palët ndihen mirë.

Për shumë meshkuj, rëndësi ka familja e mbyllur, brenda mureve, me sa më pak kontakte dhe lidhje me jashtë. Gratë mendojnë ndryshe. Këtu nisin konfliktet. Konfliktet midis frenimit dhe zhvillimit, hapjes dhe mbylljes. Meshkujt, në përgjithësi, kënaqen me ato që mendojnë ndërsa femrat me ato që dëshirojnë, kur i realizojnë. Femra është gjithmonë në kërkim për veten e vet dhe familjen. Mashkullit i pëlqen «gjumi dimëror», familja siemeze. Kur në mes futen dhe fëmijët, të cilët natyrisht që mbështesin nënën aktive, konfliktet trashen edhe më shumë. Familja bëhet e pafat.

Meshkujt fanatikë, as që mund ta mendojnë se gruaja duhet të marrë guximin për të dalë nga dera e shtëpisë e vetme, pa një mashkull. Dhe kështu e kthejnë familjen në një kafaz për gruan. Të gjithëve na ka takuar të njohim njerëz të tillë. Nëse një familje e tillë prishet, gjë që është fare normale, si duhet menduar, e pafat? Kjo është fatkeqësi e përgatitur nga burri fanatik. Qëllimi i fanatikut është ta bëjë gruan sa më të shëmtuar dhe të paafatë për sytë e të tjerëve. Prandaj shumë nga ata, e kthejnë gruan në makinë lindëse, mundësisht, një fëmijë në vit. Inteligenca dhe shkathtësitë e gruas e trembin atë.

PANDEMITË QË NDRYSHUAN HISTORINË E NJERËZIMIT, CILAT KANË QENË SËMUNDJET MË NGJITËSE

Ndërsa njerëzit janë përhapur në të gjithë botën, kështu ka ndodhur edhe me sëmundjet infektive. Edhe në këtë epokë moderne, shpërthimet janë gati konstante, megjithëse jo çdo shpërthim arrin nivelin pandemik siç ka ndodhur me koronavirusin (COVID-19).

Nëse kthehemi mbrapa në kohë do të shohim se kanë qenë jo pak pandemitë vdekjeprurëse që kanë goditur botën përgjatë historisë, që nga murtaja antonine, deri në COVID-19 që u shfaq për herë të parë në fund të vitit në kaluar në Kinë.

Një histori e shkurtër e pandemive historike

Sëmundjet e kanë vënë poshtë njerëzimin që nga ditët më të hershme të tij. Sidoqoftë, shkalla dhe përhapja e këtyre sëmundjeve u rrit në mënyrë dramatike kur ndodhi kalimi në sistemin agrar.

Tregtia e përhapur krijoi mundësi të reja për bashkëveprimet njerëzore dhe kafshët që nxisin epidemi të tilla. Malarja, tuberkulozi, lebra, gripi, lia etj u shfaqën për herë të parë në këtë kohë.

Sa më të qytetëruar bëheshin njerëzit – me qytete më të mëdha, më shumë rrugë ekzotike tregtare dhe rritje të kontaktit me popullsi të ndryshme të njerëzve, kafshëve dhe ekosistemeve – aq më shumë shtoheshin gjasat për pandemi.

Këtu janë disa nga pandemitë kryesore që kanë ndodhur me kalimin e kohës:

Pavarësisht se sëmundjet dhe epidemitë kanë qenë të pranishme përgjatë historisë, bie në sy prirja që me kalimin e kohës, shkalla e vdekshmërisë është ulur në mënyrë graduale. Ngritja dhe përmirësimi i sistemeve shëndetësore si dhe të kuptuarit e faktorëve që inkubojnë pandemitë kanë qenë mjete të fuqishme në zbutjen e ndikimit të tyre.

Zemërimi i perëndive

Në shumë shoqëri të lashta, njerëzit besonin se shpirtrat dhe perënditë u shkaktonin sëmundje dhe shkatërrim atyre që e meritonin zemërimin e tyre. Ky perceptim joshkencor shpesh çoi në përgjigje katastrofike që rezultuan në vdekjen e mijëra dhe në disa raste miliona njerëz.

Në rastin e murtajës së Justinianit, historiani bizantin Procopius i Cezaresë gjurmoi origjinën e murtajës (bakteri Yersinia pestis) në Kinë dhe Indinë verilindore, përmes rrugëve të tregtisë tokësore dhe detare për në Egjipt, ku hyri në Perandorinë Bizantine përmes porteve mesdhetare.

Megjithë njohurinë e tij të dukshme për rolin e gjeografisë dhe tregtisë në këtë përhapje, Procopius ia hodhi fajin për epideminë Perandorit Justinian, duke



Emri	Koha	Lloji e origjina	Viktimat
Murtaja antonine	165-180	Mendohet li ose fruth	5 milionë
Lia epidemike japoneze	735-737	Virusi variola major	1 milion
Murtaja justiniane	541-542	Bakteret Yersinia pestis / minjtë, pleshtat	30-50 milionë
Vdekja e zezë	1347-1351	Bakteret Yersinia pestis / minjtë, pleshtat	200 milionë
Lia e botës së re	1520 e më tej	Virusi variola major	56 milionë
Murtaja e madhe e Londrës	1665	Bakteri Yersinia pestis/ minjtë, pleshtat	100 000
Murtaja italiane	1629-1631	Bakteri Yersinia pestis/ minjtë, pleshtat	1 milion
Pandemia e kolerës 1-6	1817-1923	Bakteri V. cholerae	1 milion
Murtaja e tretë	1885	Bakteri Yersinia pestis/ minjtë, pleshtat	12 milionë (Kina dhe Italia)
Ethet e verdha	1885	Bakteri Yersinia pestis/ minjtë, pleshtat	100000-150000 (SHBA)
Gripi rus	1889-1890	Mendohet se ishte H2N2 (origjinë nga shpendët)	1 milion
Gripi spanjoll	1918-1919	Virusi H1N1 / Derrrat	40-50 milionë
Gripi aziatik	1957-1958	Virusi H2N2	1.1 milionë
Gripi i Hong-Kongut	1968-1970	Virusi H3N2	1 milion
HIV/AIDS	1981-vijon edhe sot	Virus / shimpanzetë	25-35 milionë
SARS	2002-2003	Koronavirus/ lakuriqët	770
Gripi i derrit	2009-2010	Virusi H1N1/ derrat	200 000
Ebola	2014-2016	Virusi ebola/ kafshët e egra	11 000
MERS	2015-vijon edhe sot	Koronavirus/ lakuriqët, gamilet	850
Covid-19	2019 – vijon	Koronavirus / origjinë e panjohur (dyshohen pangolinat)	9149 (19 mars 2020)

e shpallur atë si të keqen e vendit. Disa historianë zbuluan se kjo ngjarje mund të ketë dëmtuar përpjekjet e Perandorit Justinian për të ribashkuar atë që mbetej nga

Perandoria Romake në lindje dhe perëndim dhe shënoi fillimin e Epokës së Errët. Fatmirësisht, njerëzit tani i kuptojnë shkaqet e sëmundjeve dhe kjo ka sjellë

një përmirësim drastik në përgjigjen ndaj pandemive moderne, megjithëse të ngadalta dhe ende jo të plota.

Importimi i sëmundjeve

Praktika e karantinës filloi gjatë shekullit XIV, në përpjekje për të mbrojtur qytetet bregdetare nga epidemitë e murtajës. Autoritetet e kujdesshme të portit kërkuan që anijet të cilat mbërrinin në Venecia nga portet e infektuara, të hidhnin spirancën dhe të qëndronin në det për 40 ditë para se të hynin në port- origjina e fjalës karantinë është “quaranta giorni”, nga italishtja: 40 ditë.

Një nga rastet e para të studimit të epidemive përmes mbështetjes në gjeografi dhe analiza statistikore ishte në mesin e shekullit XIX në Londër, gjatë një shpërthimi të kolerës. Në vitin 1854, dr. John Snow arriti në përfundimin se kolera po përhapej përmes ujit të ndotur dhe vendosi t’i pasqyrojë të dhënat e vdekshmërisë direkt në një hartë. Kjo metodë zbuloi një grup rastesh rreth një burimi nga i cili njerëzit merrnin ujin.

Ndërsa bashkëveprimet e krijuara përmes tregtisë dhe jetës urbane luajnë një rol kryesor, në trajektoren që ndjek një pandemi ndikon dukshëm edhe natyra viru-

lente e saj.

Të gjurmosh shkallën e infeksionit

Për të gjurmuar potencialin infektiv të një sëmundjeje, shkencëtarët përdorin një masë themelore të quajtur R0, numri i riprodhimit. Ky numër na tregon se sa njerëz mund të infektojë çdo njeri që e ka infeksionin.

Listën e kryeson fruthi, sëmundja më ngjitëse me R0 12-18. Kjo do të thotë që një person i vetëm mund të infektojë, mesatarisht, 12-18 njerëz në një popullatë të pavaksinuar.


Ndërsa fruthi mund të jetë më virulent, përpjekjet e vaksinimit dhe imuniteti i komunitetit mund të frenojnë përhapjen e tij. Sa më shumë njerëz të jenë imunë ndaj një sëmundjeje, aq më pak të ngjarë ka që ajo të përhapet, duke i bërë vaksinimet kritike për të parandaluar rikthimin e sëmundjeve të njohura dhe të shërueshme.

Është e vështirë të llogaritet dhe të parashikohet ndikimi i vërtetë i COVID-19, pasi shpërthimi është ende në vijim dhe studiuesit ende po mësojnë për këtë formë të re të koronavirusit.

Urbanizimi dhe përhapja e sëmundjeve

Kthehemi atje ku e nisëm, te ngritja e lidhjeve globale dhe ndërveprimeve si forcë shtytëse që qëndron pas pandemive. Rritja e ndërveprimit njerëzor ka rritur mundësitë që sëmundja të përhapet.

REDAKSIA



*** POEZI *** ** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI ***



nga Lulash BRIGJA

SHPRESA JETON!

Kur ikin retë ,ringjallet shpresa.
Se nesër dita do jetë qetësi
Gjithmonë në prill ringjallet besimi
Se Zoti i do bijtë e tij..

Ndryshe është qielli prapa stuhisë
Ndryshe do jemi pas Pandemisë
Sepse kur jemi në ditë të vështira
Njeriu lutet për gjëra të mira

Ajo që ndodhi shekuj më parë...
Më shumë së kurrë tani besohet
Në kryq gozhdohet Krishti i pa faj
Ndërsa Baraba katil lirohet..?

Ahh sa makaber darka e fundit ..
Heshtin të gjithë por puth tradhtari..
Shkenca dhe pushteti si nuk pëlqisnin
Ndërsy të puthin ,pas sysh të vrasin

Pas dymijë vitesh nuk është legjendë
.por vjen e gjalle , dhe vjen reale ..
Ku njerëzit vdesin si kasaphane .
.shkaqet pretekstet krejt., krejt banale

Në emër të djallit .në emër të ligjit
Për pak pushtet për shumë flori
Herë nga ISIS ,herë nga "Korona,,
E keqja e tokës me emrin njeri

Dje me raketa sot me baktere
Dikush në hëne, dikush në varr
Të gjitha i paguan populli i gjorë
Që gjithmonë mbeti fajtor pa faj

Themelet jetës ja kemi prishur
Shpirtin njerëzor, dhe nënë Natyrën
Njerëzit janë bërë si egërsira
Duan të drejtat, por jo detyrën

Thonë çdo e keqe e ka një t' mire
Nesër është koha të reflektojmë.
Me shumë ta duam ne njeri - tjetrin
Më shumë në Zot ne të besojmë

O Zot i madh që krijove njerëzit
e mbi ketë toke ju dhe pushtet ...
Me mirësinë tënde na fal pak paqe .
Se çka po bëjnë se dimë as vete ..!

Shpresa jeton në mendjen time
Se shumë shpejt do vij qetësia
Në çdo pranverë rilind natyra
Në çdo pranverë rilind Mesia..!

AH VIRUS!

Ah virus djall me baktere
Që na prishe ketë pranvere
More jete dhe thave lule..
Ti në gjunjë shkencën e ule.
Në këtë botë krejt të pafytyre
Që mohon nënën natyrë.
Pasanik dhe fukara ..
Po bëjnë lutje e thonë urate

Ndoshta të ka shpik njerëzimi
Të çoj Zoti si shenjë dënimi.
E vërteta kurrë nuk thuhet.
Por nga ty gjithkush po ruhet
Mikro je por na fut tmerrin
Bota mbarë po ta shef sherrin
As para e pasuria
S'të shpëtojnë nga fatkeqësia

Këto ditë po mendoj gjatë..
- Vërtet jeta është dhuratë..
Që ne kemi për ta jetuar.
Sipas fatit që është shkruar!
Mirëpo shkenca ka vrapuar
Aq sa Zotin ka mohuar ...?
Ndoshta po na thotë Natyra..
Të rrëfehemi tek pasqyra.

Është koha ti themi vetes
Puna është burimi i jetës..
Pasuri sa për të jetuar.
Dhe shëndet për ta shijuar..
Liria është gjë e shtrenjtë.
Dhe familja shumë e shenjte.
Por me lutje dhe durim
Jeta ka tjetër kuptim..

Ti që je i pari i shtetit.
Hiqi ca para prej vetit.
Sepse mbyllur tek shtëpia
Dikush vuan nga uria...?
Dil o frat në dritare.
Ngjitu hoxhe deri n' minare.
Zot në tokë nga perëndia..
Jeni ju dhe qeveria

Është në fjalë që gjithmonë thuhet.
Trim e mençur ai që ruhet..
Ky virus e vërtetoj .
mjekët janë vërtet heronj.

Ai që ka e nuk dhuron...
Kurrë përjetë nuk i gëzon...
Në këtë botë shumë virtuale.
Po bën send vdekja virale...!

O virus mikroskopik
Mjaft na shkunde tani ik.
Shkunde mbret dhe qeveri.
Shkunde trima dhe zoteni.
Nuk e di me kë e pate ..
Se ne kemi shumë mëkate
Jeta është si një dallëndyshe
Nesër bota do të jetë ndryshe..!

TRËNDAFILI

Ti trëndafil që çel në pranverë.
syrit e zemrës i bërë nder..
Ti çel pas dimrit me akull e borë
dua të shoh të prek me dorë

Ti trëndafil që çele në prill .
lulja më e bukur , lulja më e mirë..
vetëm të të preku petalet tua..
shpirti po me ngopet ,tjetër nuk dua..
Në mars je gonxhe, në prill je lule..
Ah.. në dorën time erdhe u ule..
Pa ty nuk shkruhen vargjet as kënga.
një mijë petale edhe dy - tri gjemba

Ti trëndafil me ngjyrë dashurie.
.që ëndrrat e mija si le në hije
Kur jam pran teje përherë argëtohem..
me ty buzëqeshi , me ty frymëzohem..

Unë ta di shijen ,unë ta di vlerën.
aroma jote e rilind pranverën
Kur jam pran teje zemrës i bën nder..
Ti të gjitha stinët i bën pranvere..

AMANETI I FUKARASË

Kur erdhi në jetë
ishite engjëll si ti
si unë.
por fati e braktisi
e rreziku e deshi më shumë.

Kur iku nuk la asgjë
vetëm një kasolle
një emër ..
e një amanet .
Një emër të mirë .
që kërkoj gjithmonë
paqe dhe mëshirë

Që të prehej i qetë
në atë jetë
kasollen
ja la priftit amanet.

- Me ankand
shite kasollen time..
Le ta blejë ndonjë zoteni. ..
se kurrë në jetë
s'ma njomi dorën..
E vuajtjet e mia kanë me e përpi.!

Jeta na ndau skaj në skaj..
Unë pa bukë e ai pa shpirt
Unë i përloitur ai i mallkuar
Në fund të fundit
gëzojmë nga një varr..
- Se Zoti kështu e ka shkruar...

LARG MEJE DIMËR....?

Largohu dimër se mjaft me ty
Si ferre ndër këmbë si hije mbi sy
Mbi lotin tënd bulëzon pranvera
Kështu do vijnë dhe shume të tjera

Larg meje dimër.
.. Ti s'je për mua.
E di kush jam?
E di çfarë dua
Në jetën time ka veç një stine
Sepse në zemër kam dashurinë

Largohu dimër me rri krejt larg
Sepse ti ëndrrat mi fute në varg
Nga kohe e vjetër kujtoj një fjalë
Fatin dhe pranverën askush si ndal

KONTRAST PA FUND

Kam filluar të mërzhitem pak
kur shoh se si ..
nata e përqesh terrin e ditës
e dita lakmon dritën e natës?
Se di .
Se di por kur shoh se
tradhtia flet
nga tempulli i dashurisë..!
dashuria breh rrugëve të harresës
Më vjen të bërtas
por vetëm flas me vete .

Kur shoh se jeta shoqërohet
pa aspak mëdyshje me vdekjen
e vdekja nuk dëshiron
..... të kthehet në jetë...!
Sa kontrast dhe paradoks
kur injoranca i jep leksione diturisë
Apo kur hajduti
. lexon ligjet e drejtësisë
Mërzhitem

Mërzhitem me të vërtetë...
por vetëm hesht
hesht dhe them ...
- O Zot i madh
Si u bë lëmsh kjo botë
Ku gjerat normale duken çudi
Mashtrimi ecën rrugëve.
e vërteta fluturon mbi re
Ah po; Ekstremet.
.puthën dhe ..

përqafohen çdo dite me ne
Sa zor e kam
të mësohem me ketë realitet
në vendin tim që
çdo dite e më shume
më bëhet i huaj ...
Por duhet të duroj, të hesht dhe të vuaj...
Kur s'kam asnjë forcë vetëm të shkruaj.

REDAKSIA

Kryeredaktore: Suela Ndoja
Redaktorë: Luigj Shyti, Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Kole Çardaku, Eilda Delija, Age Martini, Klodiana Serraj, Vilson Peshkaj, Marijan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza e Ndue Ziçi.

Mundësoi Botimin:
Doktor NDUE NIKA
Avokat ANTON KOSTERI